

BASHKËSIA ISLAME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
ISLAMIC COMMUNITY OF KOSOVA

FAKULTETI I STUDIMEVE ISLAME
FACULTY OF ISLAMIC STUDIES
PRISHTINË / PRISHTINA

EPITAFET NË GJUHËN OSMANE

Deshifrimi dhe përkthimi i tyre

Regjioni i Mitrovicës

EPITAPHS IN OTTOMAN LANGUAGE

Their deciphering and translating

The region of Mitrovica

2

Prishtinë 2019

Titulli:
EPITAFET NË GJUHËN OSMANE -
DESHIFRIMI DHE PËRKTHIMI I TYRE -
REGJIONI I MITROVICËS

Titulli në anglisht:
EPITAPHS IN OTTOMAN LANGUAGE -
THEIR DECIPHERING AND TRANSLATING -
THE REGION OF MITROVICA

Botues:
Fakulteti i Studimeve Islame - Prishtinë

Redaktor përgjegjës:
Prof asoc. dr. Fahrush Rexhepi
Dekan i Fakultetit të Studimeve Islame – Prishtinë

Recensent:
Ermal Nurja
Besir Neziri

Redaksia:
Prof. ass. dr. Zija Abdullahu
Prof. ass. dr. Musa Vila

Transkriptoi, përktheu dhe përgatiti për botim:
Agron Islami
Selim Selimi

Historiku i qyteteve dhe fshatrave:
Prof. dr. Jusuf Osmani

Redaktor gjuhësor:
Fitim Veliu

Korrektor:
Vedat Shabani

Dizajni dhe faqosja:
Edib Agagjyshi

Shtypshkronja:
Fxxxxx

ISBN 978-9951-583-15-2

Epitafet
në gjuhën osmane

DESHIFRIMI DHE PËRKTHIMI I TYRE

REGJIONI I Mitrovicës

PËRGATITI PËR BOTIM:

AGRON ISLAMI

SELIM SELIMI



كُلُّ نَفْسٍ ذَآئِقَةُ الْمَوْتِ

Secili njeri do të shijojë vdekjen

Kul-lu nefsin dhâikatul mevt

Âl-i Imran 3/185

Përmbajtja

Parathënie/Önsöz...7
Hyrje...10

I. Mitrovicë
1.1. Mitrovicë...20
1.2. Mazhiq...28
1.3. Zhabar i Poshtëm...32
1.4. Koshtovë e Bobit...44
1.5. Bare...49
1.6. Lipë...54
1.7. Melenicë...58
1.8. Suhadoll i Poshtëm...60
1.9. Vaganicë...62
1.10. Vllahi...64

II. Vushtrri
2.1. Vushtrri...66
2.2. Novolan...86
2.3. Ropicë...91
2.4. Duboc...94
2.5. Lumadhi...96
2.6. Stanoc i Poshtëm...106

III. Skenderaj
3.1. Prekaz i Poshtëm...128
3.2. Polac...131
3.3. Syriganë...136
3.4. Llaushë...138
3.5. Vërboc...140

IV. Shtojcë
4.1. Azizije-Milloshevë...148
4.2. Butoc...155
4.3. Reçicë...158
4.4. Shtuticë...162
4.5. Kunushec (Urëza)...165
4.6. Siboc (Vinden) i Epërm...167

Kronologjia e epitafeve sipas kapitujve...171

Parathënie / Önsöz

Prof. asoc. dr. Fahrush Rexhepi
Dekan i Fakultetit të Studimeve Islame - Prishtinë
İslami İlimler Fakültesi Dekanı - Priştine

Epitafet *(mbishkrimet në gurin e varrit)*, janë dëshmi mbi praninë e kulturës, civilizimit, fesë, traditës dhe arkitekturës së një populli. Tekstet japin njohuri për të kaluarën dhe historinë e popullit tonë duke shërbyer si ura lidhëse mes të kaluarës dhe të të sotmes. Epitafet reflektojnë edhe historinë tonë të përbashkët me Perandorinë Osmane si dhe diversitetin tonë kulturor.

Siç kemi paralajmëruar edhe në vëllimin e parë të veprës: *"Epitafet në gjuhën osmane (Deshifrimi dhe përkthimi i tyre në regjionin e Prishtinës)"*, se ky projekt është vetëm fillimi i disa projekteve të tilla që synojmë t`i realizojmë në shtatë regjionet e Kosovës, Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë tani ka realizuar edhe librin e dytë *"Epitafet në gjuhën osmane (Deshifrimi dhe përkthimi i tyre në regjionin e Mitrovicës)"*.

Bazuar në vlerën dhe rëndësinë që kanë gurët mbivarrezor dhe duke i konsideruar si një thesar i çmuar i trashëgimisë sonë kulturore, FSI synon që përmes kësaj vepre, e cila përbëhet nga fotografitë, deshifrimi dhe përkthimi, t`a

Mezar taşları ve içindeki yazılı metinler bir milletin kültür esaslarını, medeniyetini, dinini, geleneklerini yansıtan mimari eserlerin birer parçasıdır. Yazılı metinler miletimizin tarihini, geçmişimizinolaylarıyla ilgili bilgileri veren, geçmişten günümüze medeniyyet köprüleri kuran değerler bütünüdür. Aynı zamada mezar taşlardaki yazılı metinler de Osmanlılarla olan ortak yanlarımızı ve kültürel değerlerimizin çeşitliliklerini yansıtmaktadırlar.

Birinci ciltte ifade ettiğimiz gibi *"Osmanlıca Mezar Taşları (Priştine Yöresinde Mezar Taşlarının Transkripsiyonu ve Çevirisi)"* adlı projenin ilk adımını oluşturuyor. Adı geçen proje Kosova'nın yedi bölgesini *(yöresini)* kapsayacaktır. Priştine İslami İlimler Fakültesi olarak ikinci cildi de *"Osmanlıca Mezar Taşları (Mitrociça Yöresinde Mezar Taşlarının Transkripsiyonu ve Çevirsi)"* adlı kitabı hazırlamıştır.

Mezar taşlarındaki yazılı metinlerin tarihi - kültürel değerini ve

ruajmë këtë thesar të çmuar, gjithashtu këtë lloj shkrimi të trashëguar brez pas brezi, t'ua paraqesim studiuesve dhe lexuesve si një argument më shumë për trashëgiminë kulturore dhe historike të popullit shqiptar në Kosovë. Në veçanti kur jemi dëshmitarë të asaj se këta gurë dhe tekstet e gdhendura në gurë dita ditës po zhduken nga pakujdesia dhe mosnjohja e vlerës shkencore dhe kuturore.

Vepra *"Epitafet në gjuhën osmane (Deshifrimi dhe përkthimi i tyre në regjionin e Mitrovicës)"*, e punuar nga studiuesit e fushës Agron Islami dhe Selim Selimi, përfshinë epitafet e vendbanimeve të Komunës së Mitrovicës, Vushtrrisë dhe Skënderajt. Po ashtu, në këtë vëllim është prezantuar edhe shtojca e epitafeve të mbetura nga regjioni i Prishtinës, (libri 1). Gjatë leximit dhe krahasimit mes librit 1 dhe 2, pra, epitafeve të regjionit të Prishtinës dhe atij të Mitrovicës, nuk hasim në ndonjë dallim të madh qoftë nga konstrukti fizik i gurëve mbivarrezor, qoftë nga përmbajtja e teksteve mbi gur varri.

Vepra *"Epitafet në gjuhën osmane (Deshifrimi dhe përkthimi i tyre në regjionin e Mitrovicës)",* përfshinë fotografimin, deshifrimin dhe përkthimin e të dhënave të mbi 100 personave. Gur varri, më i vjetër, i përket vitit 1592 sipas kalendarit Gregorian. Vendndodhja e këtij epitafi është në oborrin e xhamisë së Mazhiqit, komuna e Mitrovicës. Në këtë libër i gjejmë të përkthyera edhe të dhënat e personalitetve të ndryshme, si: hoxhallarëve, haxhinjve, muhaxhirëve, etj. Gjejmë emra të personaliteteve të ndryshme, të cilët kanë jetuar në këto treva gjatë periudhës së sundimit osman, por edhe më vonë. E gjejmë edhe emrin e familjes së Ferhat bej Dragës,

önemini bildiğimizden dolayı, İslami İlimler Fakültesi olarak hazırladığımız bu kitapta, mezar taşları resimlerle göstererek, yapılan transkripsiyon ve çeviriyle birlikte, umarız ki bu çalışma, okuyuculara ve araştırmacılara, Kosova'daki Arnavut tarihimizden, kültürel mirasımızdan somut birer delil olarak ortaya koymuş oluruz. Son yıllarda her geçen gün yok olmakla yüz yüze kalmış olan mezar taşlarındaki yazılı metinler, maalesef ilgisizlikten ve kültürel değerlerimizin bilgi yetersizliğinden kaynaklanmaktadır.

"Osmanlıca Mezar Taşları (Mitrociça Yöresinde Mezar Taşlarının Transkripsiyonu ve Çevirsi)" adlı kitap, Agron İslami ve Selim Selimi tarafından hazırlanmıştır. İkinci cilt, Mitroviça, Vuçitırna ve İskenderay belediyelerini kapsamaktadır. Ayrıca bu kitapta ek olarak (1. ciltte) Priştine Yöresindekikitaba alınmayan mezar taşları da eklenmiştir. Kitabı okurken 1. ve 2. cildi karşılaştırdığımda mezar taşlarındaki fiziki yapısı ve ya mezar taşlarındaki yazı ve içerik bakımından fazla bir fark göremiyoruz.

"Osmanlıca Mezar Taşları (Mitroviça Yöresinde Mezar Taşlarının Transkripsiyonu ve Çevirsi)" adlı kitapta, mezar taşları resimlerle göstererek, transkripsiyonla ve çeviriyle birlikte yüz üzerine yenişahısların isimleri verilmiştir. En eski mezar taşı miladi 1592 yılına ait olduğu tespit edilmiştir. Bu mezar taşı Mitroviça Belediyesinin Majiç köyü cami avlusunda bulunmaktadır. Kitapta çok sayıda değişik mesleklere sahip olan, hocalar, hacılar, muhacir gibi şahsiyetler yanında Osmanlı İmperatorluğu dönemine ait ve sonrasına kadar önemli şahsiyetlerin isimlerine rastlanmıştır. Yazılı mezar taşları arasından Arnavut milli tarihinde tanınmış Ferhat Bey Draga ailesinin mezar taşına da rastlanmıştır. '

personalitet i shquar në historinë e kombit shqiptar, si p.sh:

Ai (Allahu) është i Përjetshëm! Qoftë i mëshiruar dhe i falur, Ali Pashë Draga, i biri i Haxhi Ferhatit! Vdiq 1318 h.

Ashtu si në shembullin e sipërpërmendur, këto mbishkrime në një mënyrë janë karta e identifikimit të të parëve tanë. Shembulli i mëposhtëm na jepë informacione për veteranët e luftës, dëshmorët – shehidët, etj.

Qoftë i mëshiruar dhe i falur veterani i luftës dhe dëshmori (shehid), Jusufi, i biri Iljasit! Për shpirtin e tij, Fatiha! Viti 1293 (sipas kalendarit Gregorian – 1876).

Në fund theksojmë se vëllimi i parë i epitafeve dhe ky i dyti, që sapo ka rënë në duar të lexuesve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga metodologjia e punës shkencore, përbënë një arritje të pakontestueshme të Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë, të autorëve, por, gjithashtu edhe një vlerë kulturore, historike e shkencore të pamohueshme. Pas botimit të vëllimit të parë të Epitafeve për regjionin e Prishtinës, reagimet e lexuesve, studiuesve dhe profesionistëve të fushës së kulturës islame, janë mjaftë pozitive dhe vlerësuese. Në këtë kontekst vëllimi i parë tanimë është i njohur për opinionin shkencor brenda dhe jashtë Kosovës, ku vlen të theksohet se Dr. Nedim Zahiroviç ka bërë një recension për vëllimin e parë për revistën prestigjioze për studimet orientale "*Prilozi*" në Sarajevë, sikurse edhe recensionin tjetër në gjuhën angleze nga i njejti autor i botuar në revistën *Studime Orientale* në Prishtinë.

Për realizimin e këtij projekti falenderojmë mbështetësit e librit, po ashtu falenderojmë autorët Agron Islami dhe Selim Selimi, për punën profesionale, recensentin e librit Ermal Nurja, si dhe të gjithë ata që na kanë përkrahur në mënyra të ndryshme.

'Huvel Baki! El merhum vel magfur, Hacı Ferhat binti Ali Paşa Draga. Ölümü 1318 h." Örneğinde görülmektedir.

Yukarıdaki örnekte de belirtildiği gibi, bu yazılı mezar taşları bir anlamda geçmişlerimizin kimliğini yansıtmış oluyorlar. Aşağıda vereceğimiz örnekte de şehitlerden bilgi veriyor:

"Hüve, el-Merhûm ve'l-mağfûr, Gazî şehîd Yûsuf bin Ilyâs, Rûhuna Fâtiha Sene 1293/1876.".

Son olarak şunu diyebiliriz ki, kitabın birinci ve ikinci cildi okuyucuların eline geçmesiyle ister içerik veya metodoloji açısından müeliflerin verdikleri gayretler bilimsel, tarihi ve kültürel değeri bulunan bir çalışmadır. Ayrıca yapılan bu çalışmayla, Priştine İslami İlimler Fakültemiz için de büyük bir başarı olduğu kaçınılmaz bir gerçektir diyebiliriz. Priştine yöresini kapsayan mezar taşların birinci cildin yayımlanmasından sonra, İslam kültürüne ve konuya hakim olan okuyucular ve araştımacılar tarafından değerlendirilerek olumlu tepkiler almıştır. Bu anlamda birinci cilt hakkında yerli ve yabancı araştırmacılar haberdar olmuşlardır. Burada belirtmek gerekir ki, bu alanın uzmanı olan Dr. Nedim Zahiroviç kitabın birinci cildini Sarayevo'da yayınlanan *"Prilozi"* şarkiyat araştırmaları dergisinde değerlendirme yazısını Boşnakça yaparak ve aynı değerlendirmeyi İngilizce olarak da, Priştine'de çıkan *Studime Orientale (Şarkiyat Araştırmaları)* dergisinin dördüncü sayısında da yayımlamıştır. Değerlendirme metni kitabın sonunda verilmiştir.

Bu projenin gerçekleşmesini sağlayanlar başta, müelifler; Agron İslami ve Selim Selimi'ye, kitabı inceleyen Ermal Nuray'a ve her yönüyle projeye destek verenlere teşekkürlerimizi sunarız.

Hyrje

Ma. Sc. Agron Islami

Fjala *epitaf* vjen nga gjuha e vjetër greke dhe ka kuptimin e mbishkrimit në një gur varri[1], ndërsa në gjuhën osmane kjo fjalë ka kuptimin *mezar* dhe *kabir,* e që prej kësaj te fundit është formuar edhe shprehja *kabristan*, që nënkupton vendvarrezat.[2] Ceremonia e varrimit tek myslimanët fillon qysh nga djemtë e Ademit a.s.. Kjo ceremoni është përshkruar edhe në librin e shenjtë, Kur'anin, ku thuhet: "*Allahu dërgoi një sorrë, e cila groponte në dhe për t'i treguar atij se si ta mbulojë trupin e vëllait. E ai i tha*: *"I mjeri unë, a nuk qesh i aftë të bëhem si kjo sorrë, e ta mbuloja trupin e vëllait tim?" ashtu mbeti i penduar".*[3] Po ashtu, edhe shënjimi i varrezave përmes vendosjes së gurëve tek koka dhe këmbët e varrit, te të vdekurit daton që nga koha e Pejgamberit a.s., ku transmetohet se pasi që Pejgamberi a.s e varrosi njërin prej shokëve të tij në Medine, Othman bin Madhunin**,** ku tek koka e tij vendosi një gur dhe pastaj tha*:" përmes këtij guri do ta gjej (më lehtë) varrin e vëllait tim dhe do t'i varros edhe të afërmit e mi, afër tij".*[4] Megjithatë, me kalimin e kohës dhe me shtimin e të vdekurve myslimanë, lindi nevoja qe tek guri i kokës së varrit të shkruhen edhe emrat e të vdekurve në mënyrë qe gjatë vizitave të gjenden më lehtë.

Pas pranimit të fesë islame për besim, edhe shqiptarët kultivuan kulturën e mbishkrimit të epitafit *(mbishkrimit në gurin e varrit).* Këto mbishkrime i hasim gjithandej, pra në pjesën e tërë territorit të sotëm shqiptar. Këto mbishkrime, në të kaluarën, por edhe sot, kanë tërhequr e po tërheqin vëmendjen e studiuesve dhe personaliteteve të letrave shqipe, siç është rasti me poetin e mirënjohur Mitrush Kuteli, i cili gjatë një vizite që i bëri Prizrenit, më 1943, ndër të tjera shkruante: "*... Do dëshiroja fort te lexoj mbishkrimet, me nj 'ato fantastike paleografi arabe, qe asnjë nga alfabetet e ngurta evropiane nuk mund t'iu ofrohet nga bukuria. Po nuk di, dhe jam i dëshpëruar se ndofta nuk do di kurrë. Megjithëkëtë me pëlqen t'i vështroj e t'i prek me gishtërinj. Sepse me duket se kur i prek*

1 Mikel Ndreca, Fjalor Fjalësh e Shprehjesh të huaja, Prishtinë, 1986, f. 206.

2 Fatih Çavuş, Osmanlı Mezar Taşlarının Sırları, İstanbul, 2018, f.13.

3 Kur'an, sureja Maide, ajeti 31.

4 Mehmet Şener, " Kabir", DİA. İslam Ansiklopedisi, Vell. 24, f. 35.

me gishtërinj këto vepra te artit skulptural, i ofrohesh shpirtit te artistit ..."[5].

Përkundër vlerës shkencore që kanë epitafet, apo gurët varrezor, me mbishkrim osman, sidomos në skulpturë, epigrafi, gjuhësi dhe histori, nuk morën vendin e duhur në historiografinë shqiptare. Hasan Kaleshi ishte ndër të parët i cili u morë me trajtimin e epitafeve në gjuhën osmane, respektivisht në vitin 1968 në një punim të përbashkët me Ismail Erenin botuan punimin në gjuhën turke Prizren Kitabeleri[6] (Shq.: *Mbishkrimet e Prizrenit*). Një punim tjetër i cili duhet theksuar është punimi i Nimetullah Hafiz dhe Mucahit *(Myxhahid)* Asim, mbi kitabet e Prishtinës.[7] Si dhe punime të studiuesve të fushave të ndryshme që u munduan të nxjerrin emrat dhe vitet nga epitafet me tekste të shkurtëra.

Kjo nismë e mbetur në tentativë, nga studiuesit e lartcekur, gjeti realizim vetëm në vitin 2017, kur Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë, nxori nga shtypi botimin me titull "*Epitafet në gjuhën osmane - Deshifrimi dhe Përkthimi i tyre - regjioni i Prishtinës*". Ky botim, tani po plotësohet edhe me vëllimin e dytë që i takon regjionit të Mitrovicës, ku përfshihen Mitrovica me fshatra, Vushtrria me fshatra dhe Skënderaj me fshatra, si dhe disa venbanime nga regjioni i Prishtinës, të cilat kanë mbetur jashtë vëllimit të parë si pasojë e mungesës së informacioneve për ekzistimin e gurëvarreve në këto anë.

Ndryshe prej vëllimit të parë, në këtë vëllim kemi trajtuar edhe anën e fshehtësive në gjuhën e përdorur në epitafe si dhe dallimet e tyre për nga forma dhe mesazhet që përcjellin përmes formës së tyre, siç janë: gjinia, personaliteti apo edhe pozitat në shoqëri.

Gjuha dhe karakteristikat e epitafeve osmane

Sipas studiuesit Hans-Peter Laqueur, epitafet në gjuhën osmane përbëhen nga 5 komponentë:

1) Përgjërimi *(Serlevha)*;
2) Lutja *(Dua)*;
3) Identiteti *(Kimlik)*;
4) Kërkim lutje dhe
5) Viti *(Tarih)*.[8]

1. Serlevha- Përgjërim

Pjesa e parë e tekstit të epitafit quhet- *Serlevha*, që në kuptimin gjuhësor do të thotë *Titull i një teksti*[9], ndërsa në aspektin terminologjik, me këtë fjalë nënkuptojmë titullin e teksteve mbivarrezore *(epitafeve)* që shprehin cilësitë *(sifatet)* e Zotit: *Huve, Huve'l-Bâkî, Huve'l-hallâku'l-Bâkî etj.* Këto shprehje frazeologjike simbolizojnë besimin në cilësinë e Njëshmërisë, Përjetësisë, Fuqisë absolute dhe Krijimtarisë së Zotit *(Krijues i çdo gjëje)*.[10]

2. Duaja-Lutja

Pjesa e dytë e tekstit karakterizohet me duanë *(lutjen): el-merhûm (për*

5 Mitrush Kuteli, Në Prizren, midis të vdekurve dhe të gjallëve : " Jeta e re", reviste letrare, nr. 5, shtator-tetor, Prishtinë, 1943, f. 661-662.

6 Hasan Kaleşi-İsmail Eren, "Prizren Kitabeleri", VGM, Ankara, 1968, s. 76-94:i cili shumë vite më herët kishte zbuluar edhe kroniken e Myderrisit dhe Myftiut të Prizrenit Tahir Efendiut, kronikë, e cila u përkthye 27 vite pas zbulimit nga orientalistët Iljaz Rexha dhe Nehat Krasniqi, respektivisht në vitin 1995 në revisten "Dituria islame" dhe "Edukata Islame". Me gjer. Shih:Hasan Kaleshi, "Prizren kao kulturni centar za vreme turskog perioda", Gjurmime Albanologjike, nr. 1, Prishtinë, 1962, f. 91-118;Iljaz Rexha, "Monumentet Islame në kronikën e Mehmet Tahir Efendi Prizrenit", Dituria Islame, Prishtinë, nr. 69, Prishtinë 1995; Nehat Krasniqi, " Kronika (Menâkıb) e Tahir Efendiut Burim i Rëndësishëm për Historinë e Kulturës në Prizren gjatë Periudhës Osmane, Edukata Islame, nr. 57, Prishtinë 1995.

7 Nimetullaj Hafiz- Mucahit Asimov, "Priştine Kitabeleri", Çevren no. 15, Priştine, 1977, f. 17-21.

8 Hans-Peter Laqueur, Hüve-l'Bâkî, İstanbulda Osmanlı Mezar Taşları , Çev. Selahattin Dilidüzgün, İstanbul,1993.

9 Ferid Devellioğlu, Osmanlıca-Türkçe Ansiklopedik Lûgat, Ankara, 1970, f. 1130.

10 Sülejman Berk, Zeytinburnu'nun Tarihi Mezar Taşları-Zamanı Aşan Taşlar, Istanbul, 2006, f 35.

meshkujt), el-merhûme-tu (për femrat), kurse në shumë raste i bashkëngjitet edhe: *el-merhûm ve'l-mağfûr ilâ Rahmeti'l-lâh (*qoftë i/e mëshiruar nga ana e Zotit*), apo el-muhtâç ilâ rahmet-i rabbihi'l-gafûr (i nevojshëm për mëshirën e Zotit* t*ë tij)*.[11]

3. Identiteti

Informacionet më të rëndësishme që shënjojnë epitafet janë të dhënat mbi identitetit e të vdekurit. Në dy rajonet e hulumtuara deri me tani, ai i Prishtinës dhe Mitrovicës, kemi hasur në gurë të varrezave, ku përveç emrave të të vdekurve/ave dhe emrit të babait te të vdekurit, japin edhe informacione që tregojnë edhe statusin e të vdekurit në shoqëri, siç është rasti me epitafin e Haxhi Xhemailit, i cili bënë pjesë në parinë e Prishtinës[12]. Po ashtu, në këtë pjesë, gjejmë edhe vendlindjen e të vdekurve, siç është rasti me epitafet e gjetura në fshatin Koshtovë të Mitrovicës[13], apo edhe me rastin e Ibrahim Ukës nga fshati Rudar i Kazasë Kurshunlu *(Kurshumli)*[14] i varrosur në Suhadollin e Poshtëm të Mitrovicës.

Në këtë pjesë të tekstit, shohim se për fisnikërinë e vendit janë përdorur titujt: *bej*[15] (Hasibeja, e bija e Murad Beut)[16], *Ağa (Yakovalı Murteza ağa, Haci Ali ağa etj),*[17] kurse për autoritetet fetare janë përdorur këta tituj: *el-haxh*[18], *Monllah*[19] dhe *imam*.[20]

4. Dua/lutje për shpirtin e të vdekurit

Pjesa e katërt e tekstit në gur varre, është refleksion i kulturës se besimit islam për t'u lutur për shpirtin e të vdekurit, andaj jo rastësisht, kërkohet nga vizitori, në mënyrë urdhërore që t'i bëhet dhuratë shpirtit të tij/saj, një *Fatiha*. Kjo shprehet përmes kallëpit rûhiy-çün fâtiha *(për shpirtin e tij/saj, këndo një Fatiha),* por nuk mungon edhe këshillimi për të gjallët, siç është rasti me tekstet, të cilat nuk janë të shpeshta, por që hasim në disa të tilla, si p.sh tek epitafi në fshatin Vërboc: "*Nëse sot është dita ime (e vdekjes), nesër është dita jote!*", apo formulimi tjetër: " *Nga vizitori kërkohet duaja, n*ëse sot më *ka ndodhur mua, nesër (*të *ndodh) ty* ...!"[21].

5. Viti

Epitafet në gjuhën osmane, përfundojnë me vitin e vdekjes, mirëpo në disa raste, përveç vitit, hasen edhe data dhe muaji.[22] Gjatë hulumtimeve tona, kemi ardhë në përfundim se, datat në epitafet që i takojnë periudhës së sundimit osman, në këto treva, respektivisht para vitit 1912, janë shkruar sipas kalendarit islam të hixhretit *(Hixhri),*[23] por periudha pas osmane karakterizohet me përdorimin e dy kalendarëve *Hixhri* dhe atij *Gregorian,* siç është rasti me epitafin e Bekir Voces (*shih. Kap. Melenice, epitafi: 01*.).

Karakteristikat e epitafeve në regjionin e Mitrovicës

Siç shihet edhe në fotot e epitafeve, të cilat i kemi trajtuar në këtë vëllim, pjesa më e madhe e gurvarrezave të meshkujve përbëhen nga kësula, e cila në terminologji njihet me emërtime të veçanta:

11 Shih kap. Mitrovicë, Ep. nr. 1.; Kap. Mazhiq, ep. nr.1; Kap. Vushtrri, ep.nr.4,6; Kap. Verbofc, Ep.01. Kap. Milloshevë, Ep. 05.
12 Me gjerësisht shih A.Islami,S. Selimi, H. Ahmeti: Epitafet Osmane në gjuhën osmane deshifrimi dhe përkthimi i tyre (Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë, 2017, f. 72.
13 Shih Kap Koshtovë, Ep.04.
14 Shih Kap. Suhadoll i Epërm, Ep. nr. 01.
15 "Pronar tokash në sistemin e timarit..", më gjer. shih Mikel Ndreca, Fjalor Fjalësh e Shprehjesh të huaja, Prishtinë.
16 Shih Kap. Mitrovicë, Ep. nr.04.
17 Shih Kap. Vushtrri, Ep.nr. 03,08.
18 Shih Kap. Vushtrri, Ep. nr. 17.
19 Shih Kap. Vushtrri, Ep. nr.12; Kap. Verbofc, Ep. nr. 01,03,04.
20 Shih Kap. Zhabar, Ep. nr. 10.
21 Shih "Epitafet e Prishtinës ...", f.26.
22 Hans-Peter Laqueur, Hüve-l'Bâkî.., f. 94.
23 Kalendari Lunar.

Sarëqe, Fese, Kavuke etj, të cilat dallojnë nga njëra-tjetra, edhe për nga forma, por edhe për nga kuptimi që ato bartin në vetvete, ndërsa tek epitafet apo gurvarret e gjinisë femërore janë përdorur zbukurime me motive të luleve, mirëpo, ky rregull, jo gjithmonë është respektuar tek zonat tona, sikur shihet tek epitafi i personalitetit të Ali Pashë Drages,[24] i cili përmban motive të luleve, të cilat janë simbolikë e kopshteve të parajsës në botën e përtejme.

Epitafet e gjetura në regjionin e Mitrovicës janë tregues për mjeshtërinë e rrallë të gëdhendësve të gurë varreve, që falë këtyre stileve të gdhendjes, ndonëse mund të mos e dimë leximin e teksteve në osmanishte, ne mund të kuptojmë se, a bëhet fjalë për një burrë, apo grua, personalitet të shkolluar apo qytetarë të thjeshtë. Në këtë pjesë të studimit do të japim informacione rreth llojeve dhe karakteristikave të epitafeve që do të na ndihmojnë t'i bëjmë dallimet e lartcekura.

Epitafet e meshkujve

Në kulturën e shoqërisë osmane, bartja e kësulës shihej si obligim fetar, njëherit bartja e kësulës ishte prej obligimeve edhe tek të gjithë punonjësit në shtet, duke filluar nga Padishahu e deri tek nëpunësi më i ulët për nga grada në shtetin osman.[25] Njëra ndër karakteristikat më të veçanta të epitafeve në gjuhën osmane ishte gdhendja e njëjtë e kësulës që kishte bartur i vdekuri, derisa ishte në jetë.

Problemi më i madh i studiuesve në identifikimin e profesioneve përmes llojit të kësulave, qëndron në faktin se, të gjitha kësulat ishin të njëjta për nga forma, por që sipas profesioneve dallonin ngjyrat, gjë që është e pamundur të identifikohet në gurët varrezor. Megjithatë, ne do të japim informacione mbi disa prej llojeve të kësulave, të cilat i kemi hasur në terren.

Sarëku

Është shall pëlhure, i cili mbështillet disa herë rreth kësulës, apo çeleshes. Sarëqet ishin simbol i dijetarëve dhe njerëzve të ditur, por me kalimin e kohës, këtë lloj shalli filluan ta bartin të gjithë.[26] Atë *(sarëkun)*, tani përveç shtresave të theksuara më lartë e bartnin edhe myslimanët, të krishterët dhe hebrenjtë, mirëpo varësisht prej përkatësisë fetare, sarëku dallohej sipas ngjyrës që kishte.[27] Megjithatë, epitafet me sarëk përfaqësojnë personalitete që kanë qenë tregtar, zanatçinj, pjesëtarë të klerit te të gjitha gradave, e deri tek ushtarët, agallarët, njerëzit e thjeshtë dhe fëmijët.[28] Në vijim do të paraqesim disa forma të sarëqeve, të gjetura në regjionin e Mitrovicës:

24 Shih Kap. Mitrovicë, ep. nr. 03.
25 Fatih Çavuş, po aty, f. 109.
26 Po aty.
27 Nebi Bozkurt, "Sarık", TDV Islam Ansıklopedisi, vëllimi 36, f.154
28 Ali Bardhi, Varrezat në Anë të Malit – Ulqin, Ulqin, 2016, f. 30.

Kavuku

Është mbulesë e kokës për meshkuj, ku pjesa e brendshme përbëhet nga pambuku, ndërsa pjesa e jashtme mbështillet me bezë, e cila merr formën e kësulës së fryrë.[29] Kavuku ishte kësulë që bartej nga personalitete në pozita shtetërore dhe si të tilla dallohen nga njëri– tjetri, varësisht prej pozitave shtetërore që ushtroheshin nga bartësit.

Studiuesit e epitafeve dhe veshjes osmane, kavukët i kanë ndarë në disa lloje. Ne do t'i cekim vetëm disa nga këto lloje:

a) Kavuku Muxhevezze, me madhësi 30-35 cm., i mbështjellur me pëlhurë të bardhë, kurse në maje i shtohej një copë-pjesë bezi me ngjyrë të kuqe në madhësinë e arrës;

b) Kavuku Kallavi, kishte madhësinë prej 40 cm., kurse bartej nga sadriazamët, vezirët dhe admiralët, respektivisht nga pashallarët që kishin tre e më shumë nishane;

c) Kavuku Katibi, bartej nga nëpunësit në pozitën e sekretarit, postaxhinjtë.[30] Në vijim do të paraqesim disa lloje të kësulës kavuk, të gjetura në regjionin e Mitrovicës.

29 D. Mehmet Doğan, Büyük Türkçe Sözlük, İstanbul, 2008, f. 919.
30 Fatih Çavuş, po aty, f.100-105.

Kësula fes

Bartja e kësulës *fes* është bërë e obligueshme gjatë sundimit të Mahmudit të Dytë *(1808-1839)*, respektivisht në vitin 1829. Duke qenë se kësulat fes, emërtimet i morën sipas sulltanëve të kohës, kurse në terminologji këto lloj kësulash njihen si *Mahmudî* sipas Sulltan Mahmudit II, *Azizî* sipas Abdylazizit dhe *Hamidî* sipas Abdylhamitit II. Fesi është përdorur deri në vitin 1925.[31]

a) Kësulat fes *Mahmudi:* Ky lloj i kësulës kishte këtë formë, ku pjesa e poshtme ishte më e ngushtë, kurse pjesa e sipërme shkonte duke u zgjeruar, po ashtu, edhe xhufkat[32] zbukuruese, janë më të dallueshme se të tjerët, njëherit dallohet edhe për madhësinë qe ka. Ky lloj i fesit me pak modifikim ishte përdorur edhe gjatë sundimit të Abdylmexhidit *(1839-1861)*, respektivisht kësula fes Mahmudi mbështillej me sarëk (shall).[33]

b) Kësula fes *Azizi:* Siç shihet edhe në fotot e më poshtme, kësula fes *Azizi,*ndryshe prej kësulës fes *Mahmudi,* në pjesën e poshtme është më i gjerë dhe më i ngushtë se në pjesën e sipërme.

31 Po aty, f. 160-172
32 Fije pejësh për zbukurim.
33 Po aty.

c) Kësula fes *Hamidi*: E përdorur gjatë sundimit të Abdylhamitit II *(1876-1909)*. Kjo kësulë për nga modeli është pothuajse e njëjtë me kësulën fes *Azizi*, mirëpo me një madhësi dhe gjerësi më të madhe se i pari. Në zonat tona, ky stil është përdorur edhe pas periudhës osmane.

Epitafet për gjininë femërore

Gurëvarret për gjininë femërore dallojnë nga ata të gjinisë mashkullore, edhe për nga modeli, edhe për nga tematika e gdhendjes në gur. Gurvarret e femrave karakterizohen me motive të luleve dhe zbukurimeve të ndryshme që ato i vendosin në kokë sa janë në jetë. Këto zbukurime i hasim të gdhendura nëpër gurët e varrezave.

Vula e Sylejmanit/Ylli i Davudit/Davidit

Ylli gjashtëcepësh, i cili formohet nga ndërthurja e dy trekëndëshave, tek muslimanët njihet si *Hatem-i Sulejman – Vula e Sulejmanit*, tek hebrenjtë dhe te krishterët njihet si *Ylli i Davidit*. Njëherit, ky lloj ylli është i njohur edhe tek shoqëritë e vjetra hinduse që përfaqësohej, ku këta të fundit besonin në perëndinë e krijimit *(Brahma)*, në atë të rregullimit dhe mirëmbajtjes *(Vishnu),* dhe në perëndinë e shkatërrimit *(Shiva)*[34]. Në anën tjetër, pjesa më e madhe e popujve të vjetër të Lindjes, besonin se *Ylli i Davudit* përfaqëson opozitarizëm në mes pozitives dhe negatives, si p.sh. *e/imirë –*

34 Zija Abdullahu, *Studim Krahasimtar i Feve*, Prishtinë, 2010, f.64; Iskender Pala, "Mühr-ı Süleyman", *TDV Islam Ansiklopedisi,* C.31, Istanbul, 2006, f. 524-526

i/e keqe, e/ibukur - e shëmtuar, grua- burrë etj.[35] Megjithatë, ky simbol, tek muslimanët njihet si hatem-i Sulejman-vula e Sulejmanit, që përfaqëson pushtetin e pejgamberit Sulejman a.s., andaj këtë simbol e hasim jo vetëm në zbukurimet e xhamive, hamamave *(Banjave publike)*, varrezave,[36] por edhe tek flamujt e admiralëve osmanë të shekullit XVI.[37] Këtë simbol, së bashku me hënën, e cila është simbolikë e myslimanizmit[38], e kemi hasur në gur varret me mbishkrim osman, në zonën e Vushtrrisë, respektivisht në fshatin Novolan, të cilët po i paraqesim më poshtë.

Metodologjia e punës

Informacioni i parë mbi vendndodhjen e gurëve të varreve, me mbishkrim osman, është marrë nga Këshillat e Bashkësive Islame të Mitrovicës, Vushtrrisë e Skënderajt, përfaqësuesit e drejtorive komunale në komunat në fjalë si dhe nga qytetarë të ndryshëm të këtyre zonave.

Fjalët apo numrat të cilat/të cilët nuk kemi mundur t'i lexojmë për shkak të shkrimit të dëmtuar, apo edhe për shkak se nuk kemi mundur t'i japim kuptim, i kemi shënuar me pika "...", fjalët apo numrat për të cilat/cilët kemi dyshime, ose mund të lexohen edhe në versione të tjera, i kemi shënuar me pikëpyetje "?", ndërsa fjalët apo numrat të cilët/cilat mungojnë si rezultat i thyerjes së gurit, apo dëmtimit të shkrimit për shkaqe të ndryshme, qofshin ato natyrore apo nga dora e njeriut, i kemi shënuar me pika brenda kllapave: (...). Pas leximit të epitafeve, i kemi përshkruar nga origjinali dhe së bashku me përkthimin kemi dhënë edhe si transkriptim.

Duke qenë se në shumicën e epitafeve të hulumtuara, kemi vetëm vitin e vdekjes, jo edhe datën, gjatë përkthimit të datës kemi marrë për bazë datën 1 të muajit *muharrem* dhe vitin e vdekjes, i cili përputhet me muajin *tetor* të kalendarit gregorian, dhe për hirë të korrektësisë shkencore duhet të kemi parasysh se vitet e vdekjes mund të kenë diferencë një (1) vit, varësisht nga data dhe muaji i vdekjes.

Me këtë rast, shprehim falënderim për dekanin e Fakultetit te Studimeve Islame, prof. dr. Fahrush Rexhepin për mbështetjen e pakursyeshme në plotësimin e të gjitha kushteve dhe këshillat e vyeshme, nga cilësia e kryeredaktorit, recensentët, Ermal Nurja dhe Besir Neziri, për leximin dhe sugjerimet. Gjithashtu, falënderojmë edhe prof. dr. Nedim Zahiroviç për recensionin kritik të vëllimit të parë, të botuar në revistën *POF*[39] dhe *Studime Orinetale*[40], si dhe të gjithë ndihmëtarët, të cilët kontribuan në identifikimin e varrezave, me theks të veçantë mulla Asllan Murat Efendiun nga Mitrovica, i cili për ditë të tëra na shoqëroi në ekspeditat hulumtuese, në Mitrovicë e rrethinë.

35 Iskender Pala, po aty.
36 Po aty.
37 Barbarosa Hayreddin Pasha (1478-1546).
38 Yusuf Çetin, "Agrı Mezar Taşlarında ve Bezeme Unsurları", JASS, nr. 40 2015, f. 95.

39 Prilozi Za Orijentalnu Filologiju 67, Sarajevo 2018. f 133.
40 Studime Orientale 4, Prishtinë 2019, f. 109-111.

Shënim përkujtesë:

Jemi të vetëdijshëm për specifikat e lëmisë së studimeve në terren, e aq më shumë kur bëhet fjalë për objekte prej monumentesh në hapësira, të cilat për shekuj të tërë i janë ekspozuar kushteve klimatike, e që mundësia për të bërë lëshime është e mundshme dhe gjithsesi këto lëshime eventualisht mund të na përcjellin në vazhdimësi. Me këtë rast, kërkojmë mirëkuptim nga lexuesi për disa lëshime, të cilat janë bërë në vëllimin e parë, respektivisht në dhjetë epitafet e regjionit të Prishtinës, ku ka mospërputhje në vite, ndaj ne, në këtë vëllim, me qëllim të korrektësisë dhe moralit shkencor, formën e drejtë të viteve do ta japim këtu:

Ndreqje gabimesh nga vëllimi i parë:

Faqe	Është	Duhet të jetë
27	Hixhri: 1242 / Gregorian: 1826	Hixhri: 1246 / Gregorian: 1830
51	1877	1878
57	Është përsëritur fotoja	
59	12.06.1926	15.06.1924
70	Lindi më 1829, vdiq më 15. 04. 1939	Lindi më 1869, vdiq më 15. 03. 1939
91	Hixhri:1306 / Gregorian: 1888	Hixhri:1302 / Gregorian: 1884
94	Në epitaf janë dhënë dy versione me shkrim dhe me numra: me shkrim: 1149, me numër: 1139	Me shkrim: 1149. Me numër: 1139
101	Hixhri: 1002 /Gregorian: 1593	Hixhri: 1053 / Gregorian:1643
102	Hixhri: 1021 / Gregorian:1612	Hixhri: 1028 / Gregorian:1628
105	Hixhri: 1294 / Gregorian:1877	Hixhri: 1008 / Gregorian: 1599

Xhamia në fshatin Mazhiq te Mitrovicës, e ndërtuar nga gjysma e shek. XVI

I MITROVICË

1.1. Mitrovicë

Mitrovica shtrihet në skajin verior të fushëgropës së Kosovë, rrëzë kupës vullkanike të Zveçanit, në rrafshin midis lumenjve Ibër *(Angri)* e Sitnicë, kurse kufizohet nga shpatet e Albanikut, Rogoznës e Qyqavicës. Sot është qendra kryesore e rajonit verior të Rrafshit të Kosovës.

Pozita e përshtatshme gjeografike, si dhe pasuritë natyrore të këtij rajoni kanë kushtëzuar popullimin e hershëm të kësaj treve. Në bazë të zbulimeve arkeologjike, mund të thuhet se, Mitrovica me rrethinën e vet të afërme ka qenë e banuar qysh në Kohën e Re të Gurit - Neoliti *(3000 vjet para epokës sonë)*.

Lokalitetet parahistorike e vazhdojnë kontinuitetin me fiset ilire. Gjeneza e asaj shoqërie të lashtë dhe etnosit ilir vërehet në zbulimet në lokalitetin "Karagaq", ku është zbuluar një nekropolë ilire nga Periudha e Bronzit.

Edhe në qytet, afër stacionit hekurudhor, janë zbuluar altaret kushtuar perëndive romake: Jupiterit, Nemezës dhe Junonës, janë zbuluar edhe eksponate të tjera arkeologjike, siç është Statueta e Plumbtë e Muzës Terpsikora etj.

Lidhur me zhvillimin e mëtejshëm të këtij lokaliteti, në kohën e vonshme antike, gjejmë vetëm mbeturina të kështjellës në kodrën e Zveçanit, të cilat e vënë në dukje prezencën e bizantit në themelet e kështjellës së përmendur, e ku është ndërtuar fortifikata mesjetare.

Mitrovica e sotme, si vendbanim ka filluar të ndërtohet aty kah fundi i shekullit XIII dhe në fillim të shekullit XIV. Ajo e ka marrë emrin sipas kishës së Shën Dhimitrit. Mirëpo, mund të ketë për bazë thirrjen lokale të idhullit Demeter - Nëna e Tokës. Mitrovica, si vendbanim i ri, është krijuar dhe themeluar gradualisht rreth kishës së Shën Dhimitrit, në Zveçan. Për vendbanimin e ri, zuri vend emri *Dimitrovicë*. Kah mesi i shekullit XV, në një dokument raguzian, ky vendbanim është shënuar si De Dimitrouic, kurse pas mbarimit të shekullit XV, nëpër burime të ndryshme paraqitet edhe si Mitrovica. Bërthama e qytetit u formua në bregun e djathtë të Ibrit dhe lumit Lushtë.

Për Mitrovicën, prej formimit të saj si kasabë osmane, nga fillimi i shekullit XV deri në shekullin XIX, shumë udhëpërshkrues japin të dhëna të shumta në shënimet e tyre. Të gjitha të dhënat rezultojnë prej "Lamenta de fortis" të Dubrovnikut, nga viti 1445, kur Mitrovica përmendet si "De Dimitrouic". Në defterin osman të krahinarit, Isa Beg Ishakut, të vitit 1455 përmendet me emrin *Dimitrofci*, me 15 shtëpi, 13 të krishtera, 2 myslimane dhe 2 të veja. Arnold Harf, e përmend në vitin 1499 si kasabë të quajtur "Mitrix". B. Kuripeshiq, e përmendë në vitin 1530 si "Bazar Mitrovica", kurse Diferej Kanej e quan në vitin 1573 qytet të bukur në rrafsh që ka shumë pemë. Më 1600, Evlija

Çelebija, thekson se, Mitrovica shtrihet në pjesën perëndimore të fushës së Kosovës. Afër tij, nuk ka ngritje, ai është i formës rrethore sikurse veja, ndërsa është i ndërtuar nga gurët e gdhendur. Këtu, është një kështjellë e fortë me rrathë të fort që nuk mundësojnë as të rrëmihen dhe as të minohen. Në mes të ndërtesave nuk ka asnjë ndërtesë të mirë. Haxhi Kallfa, e përmend si vend administrativ.

Në defterin e përgjithshëm të Sanxhakut të Bosnjës, të vitit 1604, në kuadrin e Nahijes së Zveçanit, me emrin Dimitrovica ishin të regjistruar 4 lagje me 4 imamë; 4 muezinë; 40 të martuar dhe 10 beqarë, si dhe vet Varoshi.

Ipeshkvi, Pjetër Bogdani i Shkupit, në relacionin e datës 24 mars 1684 mbi gjendjen në Kosovë, për Mitrovicën shkruante: "Vend me 500 shtëpi, 3 orë rrugë larg prej Vushtrrisë, është e vendosur gjithashtu në fushë dhe duket si agrep sahati. Këtu lumi Sitnica bashkohet me lumin Ibër, mbi të cilin është një urë druri". Në defterin mufasal të Sanxhakut të Bosnjës, Nahija e Zveçanit, në fund të shek. XVI, është i regjistruar sheshi Dmitrovica, ku është zhvilluar tregtia, pra një zonë e përbërë nga 4 lagje me 76 familje, kryesisht të konfesionit mysliman.

Me formimin e lokalitetit të ri oriental - kasabës, Mitrovica zhvillohet më shpejt dhe merr karakter të qendrës së pushtetit të ri osman, garnizoneve ushtarake dhe ekonomisë zejtare, sidomos në kohën e ushtarakut të njohur turk, Gazi Isa Beut. Që nga ajo kohë datojnë godinat e para të ndërtuara, si: xhamia, sahatkulla, medreseja dhe hani. Rreth këtyre godinave të para u formuan edhe lagjja e parë, e cila merr emrin e *Gazi Isa Beut*. Më vonë, lokaliteti zgjerohet buzë Lushtës, rreth tregut të sotëm, ku u ndërtuan godinat e hyqmetit *(gjyqit),* xhamisë së quajtur *Qelevirdi*, hamamit, mesxhidit *(xhamisë pa minare)* të quajtur *Hoshkadin-baba*. Bërthama e kasabasë u formua në qendër të qytetit të sotëm, në mes të bregut të djathtë të Ibrit.

Prej vitit 1873, karakteri i zhvillimit të Mitrovicës merr një hov dinamik. Në këtë zhvillim ndikoi ndërtimi i hekurudhës së re vardaro-kosovare, e cila u zgjat deri në Mitrovicë. Me ndryshimet politike e territoriale në hartën gjeografike të këtyre viseve, më 1878, qyteti rritet me vendosjen e të dëbuarve shqiptarë nga Sanxhaku i Nishit nga ana e pushtetit serb, i cili i kishte pushtuar ato treva, si dhe të popullatës boshnjake, e cila iku pas pushtimit të Bosnjës nga Austro-Hungaria.

Pas Luftës së Parë Botërore, shumica e popullatës myslimane është shpërngulur në Turqi, ndërsa ky vend kolonizohet kryesisht me banorë malazezë dhe serbë prej viseve të ndryshme.

Meqë kufiri në mes të Austro-Hungarisë dhe Perandorisë Osmane u tërhoq në afërsi të Mitrovicës, ajo bëhet qendër e rëndësishme ushtarake. Këtu, pas vitit 1879, u ngritën shumë kazerma, sidomos në pjesën juglindore të qytetit, në shpatin Bajr. Kështu, Mitrovica afër kufirit fitoi rëndësinë strategjike. Sa i përket numrit të banorëve, derisa më 1878 Mitrovica kishte afër 11.000 banorë, më 1890 ajo kishte afër 21.000 banorë, bashkë me garnizonin.

Sipas sallnames osmane të vitit 1900, Mitrovica kishte 1500 shtëpi me 3418 banorë *(2275 meshkuj e 1138 femra)*.

Pas pushtimit të Mitrovicës nga pushteti serb, në vitin 1912, filloi dhuna, terrori, presioni ndaj popullatës shqiptare dhe boshnjake. Kështu filloi shpërngulja e madhe e kësaj

popullate në Turqi. Duhet theksuar se shpërngulja dhe dëbimi i popullatës shqiptare ka vazhduar edhe gjatë tërë Mbretërisë Jugosllave e deri në vitet e gjashtëdhjeta të shekullit të kaluar. Në anën tjetër, pushteti serb, përkatësisht jugosllav, filloi të sjellë kolon sllav në Mitrovicë dhe në tërë viset e Kosovës. Sipas një burimi, vetëm në Mitrovicë u kolonizuan 30 familje kolone serbe e malazeze.

Pas një stagnimi, zhvillimi i qytetit merr impuls të ri pas vitit 1931, kur filloi eksploatimi i xehes së plumbit në Trepçë. Kështu, që nga ajo kohë, Mitrovica u bë qendër e njohur industriale e Kosovës.

Me vijimin e hekurudhës së Ibrit, më 1928 dhe hapjen e minierës "Trepça" në vitin 1929, Mitrovica filloi të zgjerohet edhe më tutje, filluan të vendosen familje të shumta, sidomos ato që u inkuadruan në minierat dhe shkritoret e saj.

Sikurse shumica e qyteteve të Kosovës, edhe Mitrovica, gjatë agresionit serb në vitin 1999, përjetoi dhunën, terrorin dhe vrasjen e popullsisë së shumtë civile. Mitrovica i ngjante *Trojës* së djegur dhe të rrënuar. Janë djegur e rrafshuar shumë objekte të rëndësishme kulturore, si: biblioteka, shtëpi të vjetra me vlerë historike e arkitektonike, shkolla, kulla, xhami, tyrbe, varre, përmendore etj.

Vendi i origjinës

Varrezat e vjetra

Viti sipas kalendarit gregorian

1978

Gjendja momentale

E mirë

Epitafi nr. 1.1.1

Kitabeja në origjinal:

هو الخلاق الباقى المرحوم
والمغفور له شيخ طريقة
القادرية حمدى افندى
الرزاقى ابن الحافظ رشدى
الولده معنويا لشيخ الحاج
قدرى ربنا اته فى الاخرة
حسنة ارتحل الى رحمت ربنا
سنه ١٣٩٩ الفاتحه

Kitabeja e transkriptuar:

Hüve'l-hallâkü'l-Bâkî el-Merhûmu ve'l -magfûru-leh Şeyhu tarîkati'l-Kâdiriyye Hamdi efendi er-Rezâkî İbnü'l-hâfız Rüşdî El-veledu ma'neviyyen li'Ş-şeyhi'l-Hacc Kadrî Rabbenâ âtihi fi'l-âhireti haseneh İrtihâle ilâ Rahmeti Rabbinâ sene 1399 El-Fâtiha.

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Ai (Allahu) është Krijues i Përjetshëm! Qoftë i mëshiruar dhe i falur, shejhu i tarikatit Kadiri-Rezzaki*, Hamdi efendiu, i biri i hafëz Rushdîsë, djali në shpirt i shehut të Kadirinjve. Zoti ynë shpërbleje me të mira në ahiret (botën tjetër) U shpërngul tek mëshira e Zotit. viti 1399, Fatiha!

* Rrezaki është nëndegë e degës Halisijje të tarikatit Kadiri.

Vendi i origjinës
Varrezat e vjetra
Viti sipas kalendarit gregorian
i palexueshëm
Gjendja momentale
E mirë

Epitafi nr. 1.1.2

Kitabeja ne original:
هو الباقى
المرحوم
المغفور
حاجى ابراهيم
بن حجى
حمدى؟
روحنه فاتحه
(...)

Kitabeja e transkriptuar:
Hüve'l-Bâkî
El-merhûm
El-mağfûr
Hacı İbrahim
Bin Haci
Hamdi?
Rûhunâ Fâtiha
(...)

Përkthimi në gjuhën shqipe::
Ai (Allahu) është
i Përjetshëm!
Qoftë i mëshiruar
dhe i falur,
Haxhi Ibrahimi,
i biri i haxhi Hamdiut?
për shpirtin e tij,
Fatiha!
(...)

Vendi I origjinës

Xhamia e Mulla Veselit

Viti sipas kalendarit gregorian

1900

Gjendja momentale

I thyer

Epitafi nr. 1.1.3

Kitabeja ne original:

هو الباقى
المرحوم والمغفور
دراغه على پا شا بن
حاجى فرهاد روحيچون
فاتحه تاريخ وفاتى سنه
١٣١٨

Kitabeja e transkriptuar:

Hüve'l-Bâkî
el-Merhûm
ve'l-mağfûr
Draga Ali Paşa
bin Hâcı Ferhât
rûhiy-çün Fâtiha
târîh-i vefâtı
1318

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Ai (Allahu) është i
Përjetshëm!
Qoftë i mëshiruar
dhe i falur,
Ali Pashë Draga,
i biri i Haxhi Ferhatit.
Për shpirtin e tij,
Fatiha!
Data e vdekjes:
1318

Vendi i origjinës
Xhamia e Mulla Veselit
Viti sipas kalendarit gregorian
1887
Gjendja momentale
I thyer

Epitafi nr. 1.1.4

Kitabeja në origjinal:

هو الباقى
المرحومه والمغفوره له
حسيبه خانم بنت
مراد بك روحيچون
فاتحه تاريخ وفاتى سنه
١٣٠٥

Kitabeja e transkriptuar:

Hüve'l-Bâkî
el-Merhûmetü
ve'l-mağfûre-leh
Hasîbe Hânım
binti Murâd Bey
rûhiy-çün Fâtiha
Târîhi vefâtı sene
1305

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Ai (Allahu) është i
Përjetshëm!
Qoftë e mëshiruar
dhe e falur
Hasibe hanmi,
e bija e Murat Beut.
Për shpirtin e saj,
Fatiha!
Data e vdekjes:
1305

Vendi i origjinës

Xhamia e Mulla Veselit

Viti sipas kalendarit gregorian

1883

Gjendja momentale

I thyer

Epitafi nr. 1.1.5

Kitabeja në origjinal:

(...)
ايده مكامن جنة
المغفوره فاطمه
بنت بهرام
روحيچون
الفاتحه
[سنه] ١٣٠١

Kitabeja e transkriptuar:

(...)
Ide mekâmın(ı) cennet
el-Mağfûretü
Fatime
binti Behrâm
Rûhiy-çün
el-fâtiha
(Sene) 1301.

Përkthimi në gjuhën shqipe:

(...)
Varrin e saj bëje prej
kopshteve të
Në fillim të vitit 1998, fshati kishte 68 familje shqiptare me 613 banorë dhe 25 familje serbe me 117 banorë. Është fshati i parë i Kosovës që digjet në tërësi më 8 qershor 1998. U rrënuan e u dogjën shumë objekte banimi dhe ndihmëse si dhe u vranë disa persona, e disa ende janë të pagjetur.

Vendi i origjinës

Xhamia e Syriganës

Viti sipas kalendarit gregorian

1901

Gjendja momentale

I dëmtuar

Epitafi nr. 3.3.1

Kitabeja në origjinal:

المرحوم و المغفور
نعمان بن فرهاد
روحنه فاتحه
سنه ١٣١٩

Kitabeja e transkriptuar:

El-merhûm
ve›l-mağfûr
Nu'mân
bin Ferhâd
Rûhuna fâtiha
sene 1319

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Qoftë i mëshiruar
dhe i falur,
Numani,
i biri i Ferhatit!
Për shpirtin e tij,
Fatiha!
Viti 1319

3.4. Llaushë

Është vendbanim i njohur i Drenicës, qendër e njohur administrative, sidomos gjatë kohës së Perandorisë Osmane. Tani gjendet 3-5 km në jugperëndim të Skënderajt, i ndarë në disa lagje. Jo larg këtij lokaliteti, kah manastiri i Deviçit gjenden gjurmët e një vendbanimi të vjetër, gjyteti i quajtur nga populli Gradina, Gradac. Në fshat është ruajtur mikrotoponimi Gradina e Vojvodëve, gërmadha të një kështjelle të lashtë, afër kishës së Deviçit. Në lokalitetin e fshatit janë gjetur mbishkrime në pllaka mermeri të kohës antike që dëshmon për ekzistimin e vendbanimit dardan, si: Minerva Auc (=Augusta?).

Në dokumentet arkivore, përmendet në regjistrin kadastral të vilajetit Vëllk të vitit 1455, me emrin Lovisha, ku jetonin 97 familje, 5 të veja e 15 beqarë. Ndërsa, në defterin kadastral të Sanxhakut të Vushtrrisë të vitit 1566-74 ishin të regjistruara dy vendbanime: Gorna Levisha me 10 shtëpi e 5 beqarë dhe Sredna Levisha me 24 shtëpi e 11 beqarë. Më vonë përmendët edhe në dokumentet e tjera.

Në këtë vendbanim janë vendosur edhe familjet muhaxhire shqiptare, të dëbuara nga Toplica, pas vitit 1878, si çipçinj në prona të agallarve.

Si vendbanim i veçantë, po me këtë emër është i regjistruar në sallnamet e Vilajetit të Kosovës të vitit 1893 *(1311 h),* të vitit 1896 *(1314 h)* dhe të vitit 1900 *(1318 h.).*

Në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore, kolonët sllav u vendosën edhe në hyrje të Llaushës, kah Skënderaj, në vendin Aroqet, ose Agaj, ku kanë jetuar agallarët e Llaushës.

Në vitin 1998, Llausha kishte 460 shtëpi me 4680 banorë. Sulmi i forcave serbe mbi këtë fshat kishte filluar që nga marsi i vitit 1998 dhe zgjati deri me mbarimin e luftës në pranverë të vitit 1999. Ky fshat u sulmua me tanke dhe u bombardua me raketa tokë-tokë. Gjatë ofensivave të shumta u shkatërruan më se 398 shtëpi, shkolla, ambulanca dhe shumë objekte ekonomike e ndihmëse. Xhamia qysh në vitin 1998 është dëmtuar rëndë dhe i është shkatërruar minarja. Nga ky vendbanim janë vrarë 16 banorë civilë, 12 dëshmorë dhe 5 persona konsiderohen të zhdukur. Këtu janë zbuluar dy varreza masive.

Vendi i origjinës

Llaushë

Viti sipas kalendarit gregorian

1796

Gjendja momentale

I dëmtuar

Epitafi nr. 3.4.1

Kitabeja në origjinal:

المرحوم
حسن (؟) علي سپاهى
بن الحاج سالم سپاهى
رو حيچون الفاتحة
سنة
١٢١١

Kitabeja e transkriptuar:

El-merhûm
Hasan? Alî Sipahî
bin el-Hacc
Sâlim Sipâhî
rûhiy-çün
el-Fâtiha
Sene 1211

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Qoftë i mëshiruar,
Spahiu Hasan? Ali,
i biri i Spahiut,
Haxhi Salim!
Për shpirtin e tij,
Fatiha!
Viti 1211

3.5. Vërboc

Vendbanim në Drenicë, rreth 7 km në veri të Drenasit. Është vendbanim kodrinor dhe në lugje, i ndarë në disa lagje. Është vendbanim i vjetër i periudhës së castelumeve antike dardane. Në malet ndërmjet fshatrave Qirez, Vërboc dhe Baks, gjendet topogërmadha Gjyteti i Vërbocit. Në anën veriore Të Gjyteti gjendet topogërmadhë Gjyteti, por edhe Kalaja e Vogël.

Në dokumentet e shkruara përmendet në vitin 1314, në kartën e Shën Stefanit të mbretit Milutin, lëshuar manastirit të Banjskës, së bashku me fshatrat Dobrashecin, Çikatovën dhe Strofcin në Artakoll. Përmendet edhe në vitin 1365 në kartën e Vuk Brankoviqit. Në regjistrin e vilajetit Vëllk të vitit 1455, me emrin Vrba. Këtu, jetonin 67 familje, 9 beqarë e 4 të veja. Në defterin kadastral të vitit 1566-74 kishte 64 shtëpi e 31 beqarë. Në këtë defter të fundit është regjistruar edhe vendbanimi Gorna Virbofc me 13 shtëpi e 2 beqarë.

Në të jeton popullsia anase shqiptare, e cila më parë ishte e besimit të krishterë, nga e cila kanë mbetur mikrotoponimet: Kisha, Kroni i kishës, Arat e kishës.

Me emrin Vërbofc, është i regjistruar në sallnamet e Vilajetit të Kosovës, të vitit 1893 *(1311 h)*, të vitit 1896 *(1314 h)* dhe të vitit 1900 *(1318 h)*.

Fshati, gjatë së kaluarës historike, kishte pësuar mjaft nga pushteti serb, sidomos në luftën e Azem Bejtës.

Gjatë luftës së fundit të agresorit serb, fshati ka pësuar shumë. Jane rrënuar pjesa më e madhe e objekteve të banimit dhe të tjera. U vranë dhe u masakruan shumë banorë të këtij vendbanimi.

Vendi i origjinës

Xhamia e Vërbocit

Viti sipas kalendarit gregorian

1868

Gjendja momentale

E mirë

Epitafi nr. 3.5.1

Kitabeja në origjinal:

هو الحى الباقى
المرحوم و المغفور
المحتاج الى رحمه
ربه الغفور
سليمان افندى
ابن منلا ادم
روحيجون
الفاتحه
سنه ١٢٨٥

Kitabeja e transkriptuar:

Hüve'l-Hayyü'l-Bâkî
el-Merhûmü'l-mağfûr
el-muhtâc ilâ Rahmeti
Rabbihi'l-Gafûr
Süleymân efendi
İbn Monlla Adem
Rûhiy-çün
el-Fâtiha
Sene 1285

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Allahu është i Gjallë
dhe i Përjetshëm.
Qoftë i mëshiruar
dhe i falur,
nevojtari për mëshirën
e Zotit, Shumëfalës,
Sylejman efendiu,
i biri i Mulla Ademit!
Për shpirtin e tij,
Fatiha!
Viti 1285

Vendi i origjinës
Xhamia e Vërbocit
Viti sipas kalendarit gregorian
1820
Gjendja momentale
I dëmtuar

Epitafi nr. 3.5.2

Kitabeja në origjinal:

هوالباقى
مرحوم وير
بوفچهلي منلا
بيرام بن منلا
سليمان رحونه
فاتحه
سنه ١٢٣٦

Kitabeja e transkriptuar:

Hüve'l-Bâkî
Merhûm
Vırbofçalı
Monla Bayrâm
bin Monla Süleymân
rûhuna Fâtiha
Sene 1236

Përkthimi në gjuhën shqipe

Ai (Allahu) është
i Përjetshëm.
Qoftë i mëshiruar,
mulla Bajrami
nga Vërbovci,
i biri i mulla
Sylejmanit!
Për shpirtin e tij,
Fatiha!
Viti 1236

Vendi i origjinës

Xhamia e Vërbocit

Viti sipas kalendarit gregorian

1814?

Gjendja momentale

E mirë

Epitafi nr. 3.5.3

Kitabeja në origjinal:

هوالباق
ويربوفچهلي
مرحوم منلا
يوسف بن منلا
بيرام روحنه
فاتحه
سنه ؟ ١٢٣٠

Kitabeja e transkriptuar:

Hüve'l-Bâkî
Vırbofçalı
Merhûm Monla
Yûsuf bin Monla
Bayrâm rûhunâ
Fâtiha
Sene 1230?

Përkthimi në gjuhën shqipe

Ai (Allahu) është i
Përjetshëm.
Qoftë i mëshiruar
mulla Jusufi,
i biri i mulla Bajramit
nga Vërboci!
Për shpirtin e tij,
Fatiha!
Viti 1230?

Vendi i origjinës
Xhamia e Vërbocit
Viti sipas kalendarit gregorian
1883
Gjendja momentale
I thyer

Epitafi nr. 3.5.4

Kitabeja në origjinal:
عثمان افندي بن منلا
يوسف
روحنه فاتحه
سنه ١٣٠١

Kitabeja e transkriptuar:
Osman efendi bin
Monla Yû(suf)
Rûhunâ fâtiha
Sene 1301

Përkthimi në gjuhën shqipe
Osman efendiu, i biri
i mulla Ju(sufit)
Për shpirtin e tij,
Fatiha!
Viti 1301

Vendi i origjinës

Xhamia e Vërbocit

Viti sipas kalendarit gregorian

Nuk ka vit

Gjendja momentale

I thyer

Epitafi nr. 3.5.5

Kitabeja në origjinal:

بوكون بكنا
ايسه يارگ
سنا در
ياهو

Kitabeja e transkriptuar:

Bugün bana
Ise yarın
Sanadır
Yâ Hû

Përkthimi në gjuhën shqipe

Nëse sot është dita
ime e vdekjes,
nesër është dita jote!
I Madhëruar qofsh,
o Zot!

Pamje nga Ura e Vushtrisë

Shtojcë

Në këtë kapitull kemi trajtuar venbanimet jashtë regjionit të Mitrovicës, respektivisht venbanimet që kanë mbetur jashtë vëllimit të parë, si rezultat i mungesës së informacionit për ekzistimin e këtyre epitafeve në vendbanimet e regjionit të Prishtinës.

IV SHTOJCË

4.1. Azizije - Milloshevë

Shtrihet rreth 5 km në verilindje të Obiliqit. Është vendbanim fushor i tipit të grumbulluar. Në lokalitetin e këtij fshati, duke filluar nga vendi afër xhamisë, në perëndim, hasen mbeturinat e themeleve të shtëpive, qeremide, tulla etj. Kjo dëshmon se ai lokalitet ishte i banuar edhe më herët.

Vendbanimi i sotëm është themeluar në vitin 1864, si koloni çerkeze, ku u vendosën rreth 300 familje çërkeze. Por ato familje çerkeze, në vitin 1878 dhe 1913-14 migruan në Turqi. U pagëzua me emrin e Sulltan Azizit *(1861-1876)* Azizije.

Pas dëbimit të shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit, në vitin 1877/78, këtu u vendosen rreth 200 shtëpi shqiptare muhaxhire. Përmendet në dokumentet e shkruara në sallnamen e Vilajetit të Kosovës, të vitit 1885/86 se është i regjistruar vendbanimi Azizije dhe sibijan mektebi në te me 50 nxënës dhe 14 nxënëse. Ndërsa, në sallnamen e vitit 1887/8, po ashtu është regjistruar sibijan mektebi në Azizije me 72 nxënës.

Në një hartë gjeografike, të vitit 1906 ish vendbanimi Çerkez dhe tani në këtë kohë shqiptar muhaxhir dhe çerkezë, ishte regjistruar me emrin Orhanije, që është shtrirë në pjesën ku sot është xhamia e fshatit, në pjesën perëndimore të saj. Mirëpo, pas okupimit të Kosovës nga pushteti serb, në vitin 1913, këta, për shkak të dhunës, presionit, e terrorit detyrohen të shpërngulën në Turqi e gjetiu. Kështu që, pothuajse tërë popullata e këtij vendbanimi u shpërngul. Nga ushtria serbe, në këtë vendbanim janë vrarë shumë banorë, që nuk dihet numri i saktë i tyre, pra kjo ishte edhe arsyeja e largimit të tyre. Mbeti një numër i vogël i popullatës shqiptare. Kështu edhe në regjistrimin e vitit 1913 është i regjistruar në kuadrin e fshatit Babimoc, që quhet Babimoci i Muhaxherëve, ku së bashku kishin 392 banorë. Nga popullata vendëse e mbetur thuhet se janë shpërngulur në Turqi "në atë mahallë", përtej xhamisë.

Në këtë lokalitet, pothuajse të zbrazët, pas vitit 1920 kolonizohet me kolonë sllavë nga Hercegovina, Mali i Zi, Lika, Bosnja, Sllavonia, Banati, Serbia, nga disa fshatra të Kosovës etj. Pushteti serb, në vitin 1921 e pagëzoi me emrin Milloshevë, kinse në bazë të emrit të Millosh Obiliqit. *(Kopiliqit, J.O.)*. Këtu u kolonizuan 68 familje kolone sllave.

Në vitet e gjashtëdhjeta dhe më vonë, popullata shqiptare filloi të vendoset me shumicë në pronat e kolonëve sllav që i shisnin dhe i blenin popullata shqiptare e ardhur nga fshatrat e ndryshme, sidomos nga treva e Llapit, Gallapit, Artakollit dhe fshatrave përreth etj. Në pranverën e vitit 1999, fshati kishte 154 shtëpi me 1.520 banorë shqiptarë, 10 familje me prejardhje çerkeze dhe rreth 70 shtëpi serbe e malazeze. Nga sulmet barbare policore serbe, gjatë vitit 1999, u rrënuan më se 106 shtëpi banimi si dhe objekte të tjera përcjellëse.

Vendi i origjinës

Xhamia e Milloshevës

Viti sipas kalendarit gregorian

1890

Gjendja momentale

I dëmtuar

Epitafi nr. 4.1.1

Kitabeja në origjinal:

المرحومة
نافيه بنت شاكر
روحنه فاتحه
سنه ١٣٠٨

Kitabeja e transkriptuar:

El-merhûmetü
Nâfiye
binti Şâkir
Rûhuna Fâtiha
sene 1308.

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Qoftë e mëshiruar
Nafija,
e bija e Shaqirit!
Për shpirtin e saj,
Fatiha!
Viti 1308

Vendi i origjinës
Xhamia e Milloshevës
Viti sipas kalendarit gregorian
1890
Gjendja momentale
I thyer

Epitafi nr. 4.1.2

Kitabeja në origjinal:
المغفورة
؟ رمفس بنت
إبراهيم اغا
روحنه فاتحه
سنه ١٣٠٨

Kitabeja e transkriptuar:
El-mağfûretü
Ramfes? binti
İbrahim Ağa
Rûhuna
Fâtiha
Sene 1308.

Përkthimi në gjuhën shqipe
Qoftë e mëshiruar
Ramfes? e bija
e Ibrahim Agës!
Për shpirtin e saj,
Fatiha!
Viti 1308.

Vendi i origjinës

Xhamia e Milloshevës

Viti sipas kalendarit gregorian

1884

Gjendja momentale

I dëmtuar

Epitafi nr. 4.1.3

Kitabeja në origjinal:

هو المرحومة
قوشره
بنت حمزه
روحنه فاتحه
سنه ١٣٠٢

Kitabeja e transkriptuar:

Hüve'l-merhûmetü
Kuşra?
Binti Hamza
Rûhuna Fâtiha
Sene 1302

Përkthimi në gjuhën shqipe

Qoftë e mëshiruar,
Kushra?*
e bija e Hamzës!
Për shpirt të saj,
Fatiha!
Viti 1302

* Mund të lexohet edhe si Koshere.

Vendi i origjinës
Xhamia e Milloshevës
Viti sipas kalendarit gregorian
15. 01. 1902
Gjendja momentale
I thyer

Epitafi nr. 4.1.4

Kitabeja në origjinal:
(...)
اده لر روحنه فاتحه
احسان
المرحوم المغفورعزيزيه
قريسندن بهرام بن
سليمان روحنه فاتحه
٥ شوال سنه ١٣١٩

Kitabeja e transkriptuar:
(...)
edeler rûhuna
Fâtiha ihsân
El-Merhûmü'l-mağfûr
Azîziyye karyesinden
Behrâm bin Süleymân
rûhuna Fâtiha
5 Şevâl sene 1319

Përkthimi në gjuhën shqipe
(...)
Të bëjë dhuratë
për shpirtin e tij,
një Fatiha! Qoftë i
mëshiruar dhe i falur,
Behrami, i biri i
Sulejmanit
nga fshati Azizije!
Për shpirtin e tij një
Fatiha!
5 Shevval, 1319

Vendi i origjinës

Xhamia e Milloshevës

Viti sipas kalendarit gregorian

Mungon viti

Gjendja momentale

I thyer

Epitafi nr. 4.1.5

Kitabeja në origjinal:

الخلاق الباقى
المرحوم والمغفور
المحتاج الى رحمة
ربه الغفور
الحاج احمد
بن حسين
روحنه الفاتحه

Kitabeja e transkriptuar:

El-hallâkü'l-Bâkî
El-Merhûm
ve'l-magfûr
El-muhtâc ilâ Rahmeti
Rabbihi'l-Gafûr
el-Hâc Ahmed
Bin Hüseyin
Rûhuna el-Fâtiha.

Përkthimi në gjuhën shqipe

Ai (Allahu) Krijuesi
dhe i Përjetshmi!
Qoftë i mëshiruar dhe
i falur, nevojtar për
mëshirën e
Zotit shumëfalës,
Haxhi Ahmedi,
i biri i Hysejnit!
Për shpirtin e tij,
Fatiha!

Vendi i origjinës
Xhamia e Millosheves
Viti sipas kalendarit gregorian
1890
Gjendja momentale
I dëmtuar

Epitafi nr. 4.1.4

Kitabeja në origjinal:
المرحوم والمغفور
بهرام بن شاكر
روحنه فاتحه
سنه ١٣٠٧

Kitabeja e transkriptuar:
El-Merhûm
ve'l-mağfûr
Behrâm bin Şâkir
Rûhuna Fâtiha
Sene 1307

Përkthimi në gjuhën shqipe
Qoftë i mëshiruar
dhe i falur,
Behrami,
i biri Shaqirit!
Për shpirtin e tij,
Fatiha!
Viti 1307

4.2. Butoc

Është vendbanim kodrinoro-malor, i ndarë në grupe shtëpish, lagje që shtrihet rreth 8 km në lindje të Prishtinës. Gjurmë të lokalitetit të vjetër janë gjetur në lagjen e Statofcëve, në vendin Livadhi i Hamitit, si p.sh. themele shtëpish, tjegulla, tulla etj., pastaj është gjetur një pitos i madh. Këtu thuhet se ka qenë një kishë e vjetër shqiptare. Në rrafshin pjellor ku gjendet fshati, ka antikitete të lashta, që dëshmojnë për një vendbanim të hershëm të tipit baritor.

Në dokumentet e shkruara, përmendet, në kartën e mbretit Millutin të Manastirit të Graçanicës, në vitin 1321. Në gjysmën e parë të shek. XV përmendet vendbanimi Butin. Në defterin kadastral të vilajetit Vëllk të vitit 1455, është i regjistruar me emrin Bitol me 20 shtëpi, 2 të veja e 8 beqarë. Në defterin kadastral të vitit 1477, ky vendbanim kishte 10 shtëpi e 1 mashkull, kurse në defterin kadastral të vitit 1487 kishte 15 shtëpi, 4 meshkuj e 1 të vejë. Disa e identifikojnë me Butocin, pastaj me emrin Butofc (Bukofc) përmendet me këtë emër edhe në defterin kadastral të Sanxhakut të Vushtrrisë të vitit 1566-74, ku ky vendbanim kishte 18 shtëpi e 9 beqarë.

Thuhet se një kohë këtë fshat e kishte braktisur murtaja. Disa banorë shpërngulen në Vushtrri, ku edhe sot e mbajnë mbiemrin Butofci. Sot, në lokalitetin e këtij vendbanimi, është ruajtur mikotoponimi – Varret e Murtajës.

Në vitin 1878, këtu, u vendosen pjesëtarët e 8 vëllazërive shqiptare, muhaxhirë me rreth 18 shtëpi, shqiptarë të dëbuar nga Sanxhaku i Nishit, ndërsa shumë familje shqiptare migruan, madje disa prej tyre edhe në Turqi.

Me emrin Butofça dhe Butofc, është i regjistruar në sallnamet e Vilajetit të Kosovës të vitit 1893 *(1311 h)*, të vitit 1896 *(1314 h)* dhe të vitit 1900 *(1318 h)*.

Në vitin 1912, nga ushtria serbe ishin djegur disa shtëpi të këtij vendbanimi dhe ishin vrarë dy persona.

Në vitin 1999, fshati kishte afro 30 shtëpi me rreth 250 banorë shqiptarë. Nga agresori serb janë djegur dhe shkatërruar 10 shtëpi, kurse një banor i fshatit ka rënë dëshmor.

Vendi i origjinës
Butoc - Mëhalla e Statofcëve
Viti sipas kalendarit gregorian
1921
Gjendja momentale
I dëmtuar

Epitafi nr. 4.2.1

Kitabeja në origjinal:
المرحومه
ميحا رمضان
روحنه فاتحه
سنه ١٣٤٠

Kitabeja e transkriptuar:
El-Merhûmetü
Miha* Ramazân
Rûhuna
Fâtiha
Sene 1340

Përkthimi në gjuhën shqipe
Qoftë e mëshiruar,
Miha Ramadani!
Për shpirtin e saj,
Fatiha!
Viti 1340

Konsiderojmë se është emër përkdhelës (i shkurtuar) i Mihrijes

Vendi i origjinës

Butoc - Mëhalla e Statocëve

Viti sipas kalendarit gregorian

1902

Gjendja momentale

I dëmtuar

Epitafi nr. 4.2.2

Kitabeja në origjinal:

مرحوم
مالك بن قاسم
روحنه فاتحة
سنه ١٣٢٠

Kitabeja e transkriptuar:

Merhûm
Malik bin Kâsım
Rûhuna Fâtiha
Sene 1320

Përkthimi në gjuhën shqipe

Qoftë i mëshiruar,
Maliqi,
i biri i Kasimit!
Për shpirtin e tij,
Fatiha!
Viti 1320

4.3. Reçicë

Shtrihet në grykën e Mavriqit, nëpër lugina dhe shpatije, në përroin e Reçicës. Është vendbanim i tipit të shpërndarë, rreth 30 km në veriperëndim të Podujevës.

Gjurmët arkeologjike të kulturës materiale, gjenden në vendin e quajtur Remeqiç, ku ka tulla, tjegulla, enë të dheut etj. Sipas gojëdhënës, e cila është përcjellë brez pas brezi, gjatë shumë gjeneratave, ky lokalitet ekziston qysh nga koha e sundimit romak, edhe pse nuk është studiuar ose hulmtuar sa duhet. Elementet tjera karakteristike që vlenë të theksohen janë varrezat dhe gjurmët e një kishe, për të cilën supzohet se është e kohës së krishterizmit të hershëm.

Në dokumentet e shkruara, përmendet në vitin 1455, në defterin kadastral osman të vilajetit Vëllk ku kishte 14 shtëpi dhe 2 beqarë. Në defterin e Sanxhakut të Vushtrrisë, të vitit 1477 me emrin Reçicë, timar i Haxhiut dhe Sejdiut, ku kishte 10 shtëpi dhe 5 beqarë me të ardhura 1003 akçe. Ndërsa, në vitin 1487, poashtu në kuadër të Sanxhakut të Vushtrrisë kishte 12 shtëpi dhe 2 beqarë me të ardhura 1080 akçe. Ndërsa, në defterin kadastral të vitit 1566-74 kishte 7 shtëpi e 6 beqarë. Prej vitit 1763-1783 përmendet disa herë në regjistrin e manastirit të Deviçit.

Siç është e njohur, ushtria serbe organizoi një ekspeditë ushtarake për të ndëshkuar e masakruar popullsinë shqiptare në Mavriq të Llapit. Ekspedita u fut në fshatin Reçicë dhe kreu masakrën në familjen e Demë Ahmetit, më 28 qershor 1811, në Ditën e Bajramit. Në atë skenë të tmerrit, u masakruan 30 veta *(28 anëtarë të familjes së Dem Ahmetit dhe dy mysafirë).* Në masakrën e Demë Ahmetit morën pjesë 1.500-2000 ushtarë serbë. Në Reçicë mbetën të vrarë 20 ushtarë serbë. Pas një apeli e organizimi, nga shqiptarët, të cilët menjëherë iu vërsulën prapa. Në atë betejë mbetën të vrarë shumë ushtarë serbë, ndërsa disa u zunë robë.

Në këtë vendbanim mjaft të vjetër jeton popullsia shqiptare vendëse. Në vitin 1877/78 këtu u vendosen 5 vëllazëri shqiptare, muhaxhirë nga Sanxhaku i Nishit.

Para agresionit serb, më 1998-99, fshati kishte 15 shtëpi me 130 banorë shqiptarë. Disa familje kanë jetuar vetëm gjatë verës. Sot pothuajse fshati është i braktisur.

Vendi i origjinës

Reçicë

Viti sipas kalendarit gregorian

1823

Gjendja momentale

I dëmtuar

Epitafi nr. 4.3.1

Kitabeja në origjinal:

المرحوم المغفور
غازي محمد اغا
روحي چون الفاتحة
سنة ؟ ١٢٣٩

Kitabeja e transkriptuar:

El-Merhûmü'l-mağfûr
Gâzî
Mehmed Ağa
Rûhiy-çün
el-Fâtiha
Sene 1239?

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Qoftë i mëshiruar,
i ndjeri,
veterani i luftës,
Mehmet Aga!
Për shpirtin e tij,
Fatiha!
viti 1239?

Vendi i origjinës
Reçicë
Viti sipas kalendarit gregorian
1823
Gjendja momentale
I thyer

Epitafi nr. 4.3.2

Kitabeja në origjinal:
المرحوم المغفور
غازي يحيى
روحي چون
فاتحة
سنة ؟ ١٢٣٩

Kitabeja e transkriptuar:
El-merhûm
ve'l-mağfûr
Gâzî Yahyâ
Rûhiy-çün Fâtiha
Sene 1239?

Përkthimi në gjuhën shqipe
Qoftë i mëshiruar
dhe i falur,
veterani i luftës,
Jahja!
Për shpirtine tij,
Fatiha!
Viti, 1239?

Vendi i origjinës

Reçicë

Viti sipas kalendarit gregorian

Mungon

Gjendja momentale

I thyer

Epitafi nr. 4.3.3

Kitabeja në origjinal:

المرحوم والمغفور ....
غازي
(...)

Kitabeja e transkriptuar:

El-merhum
ve'l-mağfûr
Gâzi
(...)

Përkthimi në gjuhën shqipe

Qoftë i mëshiruar
dhe i falur,
i ndjeri,
veterani i luftës
(...)

4.4. Shtuticë

Ky vendbanim gjendet në pjesën qendrore të Drenicës, rreth 8 km në veri të Drenasit. Është vendbanim kodrinor, i ndarë në disa lagje.

Në këtë fshat, në vendin Gurajë, ekziston mikrotoponimi Llazi i Gradinës dhe Lama e Gradinës, pastaj Te Llazi i Therrave, në lindje të fshatit, një vend i rrafshtë në një kodrinë të një gërmadhe, ku mendohet se dikur ka qenë një kështjellë. Aty afër ekziston edhe një shpellë mjaft e madhe që quhet Bira e Ujkut. Ndërsa, në vendin Gurina, ekzistojnë disa humnera karakteristike, vertikale e pastaj horizontale, të cilat ende nuk janë gjurmuar. Ekzistojnë edhe varreza shumë të vjetra, jomyslimane. Në fshat ka ekzistuar edhe një kishë e vjetër parasllave, ku është ruajtur edhe mikrotoponimi.

Në dokumentet e shkruara, përmendet në vitin 1365, kur Vuk Brankoviqi me vëllezër ia jep manastirit të Hilandarit disa fshatra, siç është edhe fshati Shtuçinci *(sot Shtutica, përkatësisht Suka).* Në regjistrin kadastral të vilajetit Vëllk, të vitit 1455, fshati është shënuar me emrin Gorni Stugjinci, i lënë shkretë dhe Dolni Stugjinci me 10 shtëpi. Në regjistrimet e ardhshme osmane nga vitit 1477 është regjistruar si Gornji Stuçinci, me 36 shtëpi, 1 e ve e 5 beqarë dhe Doljni Stuçinci në vitin 1477 me 5 shtëpi, 2 meshkuj dhe në vitin 1487 me 3 shtëpi e 3 meshkuj.

Me emrin Ishtutinca është i regjistruar në sallnamet e Vilajetit të Kosovës, të vitit 1893 *(1311 h)*, të vitit 1896 *(1314 h)* dhe të vitit 1900 *(1318 h)*.

Nga ky fshat, disa familje që nga periudha osmane, por sidomos gjatë pushtimit të Serbisë, më 1912, dhe në periudhën ndërmejt dy luftërave botërore, kanë migruar në Shqipëri e Turqi disa familje si p.sh.familja Bajraktari, më 1929.

Sipas shënimeve të Kuvendit komunal, të mbledhura menjëherë pas mbarimit të luftës në vitin 1999, ky fshat kishte 137 shtëpi me 1012 banorë. Fshati, gjatë luftës së fundit të agresorit serb, në vitin 1998 dhe 1999 ka pësuar shumë. U shkatërruan pothuajse të gjitha objektet e banimit dhe të tjera si dhe janë vrarë shumë banorë të këtij fshati.

Vendi i origjinës

Shtuticë

Viti sipas kalendarit gregorian

1887

Gjendja momentale

E mirë

Epitafi nr. 4.4.1

Kitabeja në origjinal:

هوالباقى
المرحوم سليمان
الحاج شعبان
روحنه فاتحه
سنه ١٣٠٥

Kitabeja e transkriptuar:

Hüve'l-Bâkî
El-Merhûm
Süleymân
El-Hâc Şa'bân
Rûhuna Fâtiha
Sene 1305

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Ai (Allahu) është i
Përjetshëm.
Qoftë i mëshiruar,
Sylejmani,
Haxhi Shabani!
Për shpirtin e tij,
Fatiha!
Viti 1305

Vendi i origjinës
Shtuticë
Viti sipas kalendarit gregorian
1899
Gjendja momentale
E mirë

Epitafi nr. 4.4.2

Kitabeja në origjinal:

مرحوم
بالى بن عثمان
روحنه فاتحه
سنه ١٣١٧

Kitabeja e transkriptuar:

Merhûm
Bali bin Osman
rûhunâ fâtiha
1317

Përkthimi në gjuhën shqipe

Qoftë i mëshiruar
Bali, i biri i Osmanit!
Për shpirtin e tij,
Fatiha!
1317

4.5. Kunushec (Urëza)

Shtrihet rreth 7 km në jug të Besianës. Është vendbanim kodrinor dhe fushor, i ndarë në lagje. Në pjesën lindore të fshatit, në vendin Arat e Qurshisë, janë gjetur themele me gurë të shtëpive të ndryshme, ndërsa në anën veriore janë gjetur pjesë të farkatarisë, copa të metalit etj., kurse në vendin Shpati i Qejve, ekzistojnë gypat e qeramikës së ujësjellësit. Gjurmë të vjetra ka edhe në lagjen Dedaj. Flitet se varrezat e këtij fshati janë mjaft të vjetra, se në to janë varrosur edhe banorët nga fshati Shajkofc - Batllavë. Edhe në vendin Arat ner Drum, ka gjurmë të kulturës materiale. Janë gjetur tjegulla, tulla, monedha etj. Në lagjen e Bajgorëve ka disa varreza të moçme me mbishkrime në gjuhën persiane.

Përmendet në defterin kadastral të Vilajeti Vëllk me emrin Kunishefc të vitit 1455 me 35 shtëpi, 10 beqarë e 2 të veja. Më 1690 pësoi dëme të mëdha nga lufta Austro-osmane. Në fillim të shekullit XVIII kishte 12 shtëpi shqiptare.

Në sallnamen e Vilajetit të Kosovës të vitit 1893 *(1311 h)*, të vitit 1896 *(1314 h)* është i regjistruar me emrin Kanoshefçe, ndërsa në atë të vitit 1900 *(1318 h.)* me emrin Kunushefç, në kazanë e Vushtrrisë. Në Urzë *(Kunushefc)*, sikurse edhe në vendbanimet tjera ka jetuar dhe jeton popullsia shqiptare autoktone, edhe pse gjatë historisë ka pasur lëvizje të mëdha të popullsisë prej një vendbanimi në tjetrin.

Pas dëbimit të shqiptarëve muhaxhirë nga Sanxhaku i Nishit, në vitet 1877/78 në këtë vendbanim u vendosen familjet muhaxhire Visokët dhe Lushakët, si dhe në lagjen e Kolibaxhive është vendosur famlja Gjakali. Sipas një harte etnografike të fund shek. XIX dhe fillim të shek. XX, ky vendbanim kishte 40 shtëpi shqiptare. Serbët dhe malazezët këtu u vendosen më vonë. Në vitin 1914 u vendos një familje nga Zhupa e Aleksandrovaqës, ndërsa, pas Luftës së Parë Botërore në të u vendosën 24 familje kolone sllave.

Nga ky vendbanim disa familje muhaxhire dhe të tjera ishin shpërngulur në Turqi *(Visokët)*. Mirëpo, duhet theksuar se në vitet e pesëdhjeta shumë familje ishin përgaditur për t'u shpërnguljur në Turqi. Fshati ishte dëmtuar gjatë pushtimit serb në vitin 1912, dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore nga ana e bullgarëve.

Shënimet statistikore: Në vitin 1913 kishte 215 banorë; në vitin 1921 - 35 shtëpi me 228 banorë; në vitin 1948 - 57 shtëpi me 433 banorë; në vitin 1953 - 59 shtëpi me 468 banorë *(294 shqiptarë, 173 serbë, 1 malazias)*; në vitin 1961 - 52 shtëpi me 355 banorë *(263 shqiptarë, 91 serbë, 1 turk)*; në vitin 1971 - 75 shtëpi me 419 banorë *(366 shqiptarë, 53 serbë)*; në vitin 1981 - 85 shtëpi me 570 banorë *(565 shqiptarë, 5 serbë)*. Sipas regjistrimit serb të vitit 1991 kishte 2 banorë serbë.

Në vitin 1999 kishte 120 shtëpi me rreth 890 banorë shqiptarë dhe një shtëpi serbe. Agresori serb në këtë vit rrënoi 50 shtëpi dhe objekte të tjera banimi, pastaj shkolla është djegur pjesërisht dhe dokumentacioni i djegur i saj, si dhe dy miniferma, etj. Nga ky fshat janë vrarë 4 persona *(2 gra, 1 plak dhe 1 burrë)*. Një kohë ishte Shtabi i UÇK-së, Zona Operative e Llapit. Popullata më 21 mars 1999 u dëbua nga fshati dhe u strehua nëpër male, e pastaj një numër i madh u dëbua jashtë Kosovës.

Vendi i origjinës
Kunushec
Viti sipas kalendarit gregorian
1908
Gjendja momentale
E mirë

Epitafi nr. 4.5.1

Kitabeja në origjinal:

المرحوم
المغفور
سليمان بن
مقصود
روحيچون
الفاتحه
سنه ١٣٢٦

Kitabeja e transkriptuar:

el-Merhûm
el-Mağfûr
Süleyman bin
Maksûd
Rûhiy-çün
El-Fâtiha
Sene 1326

Përkthimi në gjuhën shqipe

Qoftë i mëshiruar
dhe i falur,
Sylejmani i biri
i Maksudit,
Për shpirtin e tij,
Fatiha!
Viti 1326

4.6. Siboci (Vinden) i Epërm

Shtrihet 7 km në jug të Besianës. Është vendbanim fushor, i tipit të grumbulluar, në formë të zgjatur, i përbërë nga disa lagje. Për shkak të afërsisë me Vendenisin dhe të disa gjetjeve arkeologjike, lokaliteti i këtij vendbanimi ishte i banuar që nga antika. Në lagjen e Kolibaxhive janë gjetur themele shtëpish që e dëshmojnë këtë. Sipas legjendës thuhet se prej Labuce *(Lluzhani)* e deri në Besianë *(Podujevë)* ishte vendbanim i dendur, sa që macja ka mundur të ecë nëpër kulme. Sipas informatorit tërë lokaliteti prej këtij vendbanimi e deri në Besianë në gjatësi 5 km dhe gjërsi 1 km është plotë me gjurmë arkeologjike. Janë gjetur shumë themele të shtëpive, tulla të pjekura, një varrezë e një vajze, me një gurë mermeri prej 5 tonësh, sjellë nga Rumania, disa unaza, bylyzykë. Mirëpo, këto në vitin 1961 janë dërguar në Beograd. Në mes të katundit ka pasur varreza të moçme, me gurë të gjatë.

Si vendbanim me emrin Sibovc e hasim në një hartë austriake të hartuar në bazë të shënimeve të vitit 1689, si duket ka të bëjë me Sibocin e Poshtëm. Mirëpo, si duket ky lokalitet ishte i pa banuar një kohë të gjatë. Nuk dimë se kush kanë qenë banorët e vjetër. Vendbanimin e sotëm e rithemelojnë familjet muhaxhire të cilat në vitin 1877/1878 ishin dëbuara nga Sanxhaku i Nishit. Pas qëndrimit nëpër vise të tjera të Kosovës, e sidomos të Gjilanit, me qëllim që të jenë sa më afër kufirit për t'u rikthyer në vendlindje vijnë dhe vendosen në këtë vendbanim. Aty ishte llugë me therra. Popullata e çeli dhe ndërtoi disa shtëpi - koliba dhe u vendos aty. Ata në mes vete lidhën besën që mos të martohen në mes tyre, kështu që edhe sot e zbatojnë këtë vendim.

Nga popullata familjet që u vendosën në brengun e djathtë të lumit Llap quheshin Kolibaxhi, ndërsa ato në bregun e majtë – Tupanxhi.

Pra, rreth vitit 1881 këtu u vendosen këto vëllazëri munaxhire shqiptare: Muzaqët, Tullarët, Starasellët, Kojçiqët, Mexhuanët, Konjuhët, Kozmaqët, Simnicët, Toçanët, Merofcët, Tmavalitë, Bërbatofcët, Kastratët, Gjakajt, Spancakët, Bllacakët, Paçaradët, Maçastenët dhe Shulemajët me më tepër se 38 familje.

Në sallnamet e Vilajetit të Kosovës të vitit 1893 *(1311 h)*, të vitit 1896 *(1314 h)* dhe të vitit 1900 *(1318 h)* është i regjistruar me emrin Sibofçe-i Loga *(Sibofci i Llugave J.O.)*.

Sipas një harte etnografike të fund shek. XIX dhe fillim të shek.XX, ky vendbanim kishte 40 shtëpi shqiptare. Serbët dhe malazezët vendosen në këtë fshat pas Luftës së Parë Botërore, përkatësisht në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore. Këtu u vendosen më se 38 familje kolone serbe e malazeze. Kolonët u vendosën prej vitit 1920-1927 dhe ishin nga Mali i Zi, Lika, Toplica, etj. Thuhet se kolonët ishin edhe në pjesën e tokës ku kanë qenë varrezat e vjetra të popullatës shqiptare, ku edhe kanë ndërtuar shtëpi,

kështu që edhe sot ato janë të zhdukura. Kolonët sllavë janë shpërngulur kryesisht në vitet e shtatëdhjeta të shekullit të kaluar. Në vitet e tetëdhjeta kishin mbetur vetëm 2 shtëpi.

Shumë familje shqiptare, rreth 50 sosh pas vitit 1912 dhe më vonë janë shpërngulur në Turqi e gjetiu, si Starasellët, Muzaqët në Shqipëri rreth viteve 1924-25, Konjuhët, Spancakët, Kojçiqët, Maqestentët, Shulejamet, Gërgurët dhe pothuajse nga të gjitha vëllazëritë janë shpërngulur në Turqi.

Familjet e Merofcëve janë shpërngulur në Sfeçër dhe në rrethinë të Lypjanit. Disa familje të Shulemajve dhe të Meqestenëve janë shpërngulur në vise të tjera.

Shënimet statistikore: Në vitin 1913 kishte 355 banorë; në vitin 1921 - 49 shtëpi me 317 banorë; në vitin 1948 - 45 shtëpi me 311 banorë; në vitin 1953 - 79 shtëpi me 523 banorë *(321 shqiptarë, 199 serbë, 3 malazez)*; në vitin 1961 - 92 shtëpi me 604 banorë *(389 shqiptarë, 212 serbë, 3 malazez)*. në vitin 1971 - 107 shtëpi me 617 banorë *(538 shqiptarë, 77 serbë, 2 malazez)*; në vitin 1981 - 108 shtëpi me 789 banorë *(779 shqiptarë, 10 serbë)*.

Sipas regjistrimit serb të vitit 1991 kishte vetëm 1 banor serb.

Në vitin 1999 kishte 135 shtëpi me rreth 1300 banorë shqiptarë. Nga agresori serb janë djegur 57 shtëpi dhe disa objekte të tjera ndihmëse. Nga ky fshat 11 persona janë të vrarë *(1 plak, 1 grua, 6 burra të moshuar dhe 3 të rinj)*. Më 21 mars 1999 popullata u detyrua ta braktis fshatin dhe u strehua nëpër fshatra të tjera si në Kolaj, pastaj në Besianë *(Podujevë)*, etj.

Vendi i origjinës

Sibofc

Viti sipas kalendarit gregorian

1905

Gjendja momentale

I thyer

Epitafi nr. 4.6.1

Kitabeja në origjinal:

هوالباقي
المرحوم المغفور
ولچترين قضاسندن
غلامنك قريلى
منلا زينل بن لطيف
روحنه فاتحه
سنه ١٣٢٣

Kitabeja e transkriptuar:

Hüve'l-Bâkî
el-Merhûmü'l-Mağfûr
Vılçıtrîn kazâsından
Glamnik karyeli
Molla Zeynel
bin Latîf
Rûhuna Fâtiha
Sene 1323

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Ai (Allahu) është
i Përjetshëm.
Qoftë i mëshiruar
dhe falur Molla
Zejneli i biri i Latifit
nga fshati Gllamnik,
kazaja e Vushtrrisë.
Për shpirtin e tij
Fatiha!
Viti 1323



Pamje nga Mitrovica e vjetër - Xhamia e Ibrit, e shkatërruar gjatë luftës së fundit me 1999

KRONOLOGJIA E EPITAFEVE SIPAS KAPITUJVE

Emri/Emri i Babës	Vendnodhja e Epitafit	Viti hixhri/ Miladi-Gregorian	Kapitulli	Nr. i epitafit	Prejardhja
			MITROVICË		
Fatime/Behram	Xhamia e Mulla Veselit	1301/1883		05	
Hasibe/Murat	--	1305/1887		04	
Ali Pashë Draga/Ferhat	--	1318/1900		03	
Hamdi efendi Rrezak/hafız Reshad	Varrezat e vjetra	1399/1978		01	
Ibrahim/Hamdi	--	--		02	
			MAZHIQ		
Murtezan/Osman	Xhamia e Mazhiqit	1000/1592		01	
Idris/Hazir	Varrezat e Mazhiqit	1340/1921		02	
Ismail/?	--	1927		03	
			ZHABAR		
Halid/Jusuf	Varrezat e Zhabarit	1268/1851		07	
?/Junus		1304/1886		05	
Sylejman/Islamil		1312/1894		01	Zhabar
Mufid/Nezir		1321/1903		06	
Sylejman/Shaban		1304/1886		04	Koshtovë
Idris/Behram		1353/1934		02	
Nazif/Bajram		1354/1935		03	
Fazile/Beshe		1372/1953		11	
Rexhep/Bejtullah		1393/1974		10	
Rifat/Rexheb		1932 (lindja)		08	
Bejtullah/Jahja		??		09	
			KOSHTOVË		
Bajram/Bajram	Koshtovë	1297/1879		03	
Adem/Bajram		1299/1881		02	
Bajram/Adem		1282/1865		01	
Ramadan/Ramadan		1330/1912		04	
			BARE		
Ali/Hasan	Varrezat e Bares	1194/1780		01	
Muhammed/Hamid		1315/1898		02	
Dervish/Fejzullah		1313/1895		03	
Feko/Ali		1307/1889		04	

Emri/Emri i Babës	Vendnodhja e Epitafit	Viti hixheri/ Miladi-Gregorian	Kapitulli	Nr. i epitafit	Prejardhja
			LIPË		
Rexheb/Rexheb	Varrezat e Lipës	1339/1920		3	
?/Rexhep muhtar (kryeplaku)		?			
Rexheb/Ahmed		?		0	Urumiç?
			MELENICË		
Bekir Voca	Melenicë	1341/1923		01	
			SUHADOLL		
Ibrahim Uka	Suhadoll i Muhaxherëve	1326/1908		01	Rudar, kazaja Kurshunlu
			VAGANICË		
Nuro/Ibrahim	Varr. Vaganicë	1234/1818		01	
			VLLAHI		
Iljas/Sadik	Varr. Vllahi	1216/1801		01	
			VUSHTRRI		
Sefire/Haxhi Mahmud		1211/1796		03	
Shaban/Jusuf		1294/1877		05	
Azize/Nezir		1304/1886		06	
Gylfirarz Feride/Haxhi Agush		1310/1892		04	
Esma/Ajvaz		1311/1893		14	
Murteza Aga	Varr. Vushtrri	1324/1906		08	Gjakovë
Jusuf/Hasan Aga		1327/1909		02	
Jusuf/Shaban		1327/1909		07	
Nurishah/Hajdar		1327/1909		15	
Haxhi Mustafa/Haxhi Ali Ağa		1919		09	
Rukije/Jusuf Aga		1341/1922		10	
Lejla/Shaqir Aga		1922		11	
Tahire/Hava		1354/1935		13	Pasoma dhe Beraniku
Tahir/Hajdar		1355/1937		01	Pasoma
Mehmed/?		?		16	
Veterani Aziz/Mulla Mahmud				12	
Osman ağa/Haxhi Hazir	Muzeu i Vushtrrisë	?		17	
			NOVOLAN		
Hasan/Zahir Riza	Varr. Novolan	1203/1788		01	
Sylejman/Mihona?		1375/1955		03	
Raif Sait/?		1378/1958		04	
Bajram/Hysejn		?			

Emri/Emri i Babës	Vendnodhja e Epitafit	Viti hixheri/ Miladi-Gregorian	Kapitulli	Nr. i epitafit	Prejardhja
			ROPICË		
Shaqir/Fazli	Varr. Ropicë	1263/1864		01	
Arif/Halid		1326/1908		02	
			DUBOC		
Ahmed/Murad	Varr. Duboc	1194/1780		01	
			STANOC I POSHTËM		
Ali/Mefa	Varr. e Stanocit	1299/1881		08	
Sherif/Elkas		1300/1882		09	
Jusuf/Abid		1302/1884		07	
Zize/ ?		1300/1884		17	
Gugu/İbrahim		1305/1887		13	
Asife/?		1306/1888		21	
Harun/Musa		1308/1890		10	
Fatime/Mirza Beğ		1308/1890		14	
Jakub/Shuzuk?		1307/1889		11	
Zejneb/Davud		1309/1891		18	
Mahmud/Davud		1309/1891		15	
Buzar/Abid		1309/1891		12	
Davud/Ismail		1312/1894		19	
Fatime/Ismail		1326/1903		02	
Behnaze?/İbrahim		1339/1920		06	
Feride/Junus		1340/1921		05	
Xhevaxhid?/Bimar?		1340/1921		01	
Hyrije/Hazesher		1340/1921		20	
Bekir/İsmail		1338/1968		04	
Belkis/Milmirza		---		03	
Nasrihan/?		---		16	
			LUMADH		
Batuka/Musa	Varr. Lumadh	1271/1855		09	Çerkez
Ibrahim/Komiç		1299/1881		05	
Hafiza/İsmail		1290/1873		06	
Shehid Yusuf/İljas		1293/1876		08	
Hasa/ Haxhi İsmail		1314/1896		02	
Ahmed/Haxhi Musa		1314/1896		07	
Paku?/?		?		01	
Nuh/Semirez?		?		04	Muhaxher
Osman/Kameneri		?		03	

Emri/Emri i Babës	Vendnodhja e Epitafit	Viti hixheri/ Miladi-Gregorian	Kapitulli	Nr. i epitafit	Prejardhja
			SKËNDERAJ		
			PREKAZ		
Malik/Hajdar	Varr. Prekaz	1267/1850		01	
Hysejn/Hajdar		1297/1879		02	
			POLAC		
Abdullah/Ali	Varr. Polac	1213/1798		02	
Hava/Selman		1271/1854		03	
Zejneb/Adem		1298/1880		04	
Feriz/Bejazir		1313/1895		01	
			SYRIGANË		
Numan/Ferhad	Xhami e Syriganës	1319/1901		01	
			LLAUSHË		
Said/?	Rrugës për Llaushë	1211/1796		01	
			VERBOC		
Mulla Jusuf / Mulla Bajram	Xhami e Vërbocit	1230/1814		03	Vërbofc
Mullah Bajram/ Mulla Sylejman		1236/1821		02	Vërbofc
Sylejman/Mulla Adem		1285/1868		01	
Osman efendi/Mulla Jusuf		1301/1883		04	

KRONOLOGJIA E KAPITULLIT IV -SHTOJCËS

Emri/Emri i Babës	Vendnodhja e Epitafit	Viti hixheri/ Miladi-Gregorian	Kapitulli	Nr. i epitafit	Prejardhja
			AZIZIJE-MILLOSHEVË		
Kushra/ Hamza	Xhamia e Milloshevës	1302/1884		03	
Behram/Shaqir		1307/1890		06	
Ramfes/İbrahim		1308/1890		02	
Nafije/Shaqir		1308/1890		01	
Behram/Sylejman		1319/1902		04	Fshati Azizije
Ahmed/Hysejin		?		05	
			BUTOC		
Malik/Kasim	Varr. Butoc	1320/1902		02	
Miha/Ramadan		1340/1921		01	
			REÇICË		
Veterani Mehmet Ağa		1239/1823		01	
Veterani Jahja		1239/1823		02	
			SHTUTICË		
Sylejman/ Haxhi Shaban	Varr. Shtuticë	1305/1887		01	
Bali/Osman		1317/1899			
			KUNUSHEC		
Sylejman/Maksud	Lagja e Bajgorëve	1326/1908		1	
			SIBOC		
Zejenl/Nazif	Xhamia e Vjetër	1323/1905		1	Gllamnik-Vushtrri

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

94(496.51).05
929.55(496.51-2)
Epitafet në gjuhën osmane : deshifrimi dhe përkthimi i tyre: regjioni i Mitrovicës / Përgatiti për botim Agron Islami, Selim Selimi. – Prishtinë : Fakulteti i Studimeve Islame, 2019. – 180 f. : 21 cm.
Titulli paralel në gjuhën shqipe dhe angleze. – Parathënie : f. 5-6
1. Islami, Agron 2. Selimi, Selim
ISBN 978-9951-583-15-2